



Instituti i Kosovës për Drejtësi  
Kosovo Law Institute  
Kosovski Institut Pravde

13/2021



# **Krimet kundër integritetit seksual në Kosovë**

Prishtinë, maj 2021

Autore: Sabina Pergega, Florentina Osmani, Avni Berisha

Ekipi redaktues: Betim Musliu, Ehat Miftaraj, Gzim Shala dhe Yll Zekaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

*Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.*

Ky botim është produkt i projektit “Kërko Drejtësi: Fuqizimi i qasjes në drejtësi në Kosovë”, i cili mbështetet nga Departamenti i Shtetit Amerikan përmes Byrosë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe zbatohet nga Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD në partneritet me Iniciativa për Progres – INPO.

## RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD


Rr. Rustem Statovci

Prishtinë

E: [info@kli-ks.org](mailto:info@kli-ks.org)

[www.kli-ks.org](http://www.kli-ks.org)

Përkrahur nga:



**National Endowment  
for Democracy**  
*Supporting freedom around the world*

Mars, 2021

Prishtinë, Republika e Kosovës

**Lista e shkurtesave:**

<b>DKR</b>	Departamenti i Krimeve të Rënda
<b>DP</b>	Departamenti i Përgjithshëm
<b>GjA</b>	Gjykata e Apelit
<b>GjTh</b>	Gjykata Themelore
<b>IKD</b>	Instituti i Kosovës për Drejtësi
<b>KGJK</b>	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
<b>KPK</b>	Kodi i Përkohshëm Penal
<b>KPRK</b>	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
<b>KPPRK</b>	Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës
<b>KRPRK</b>	Kodi i Ri Penal i Republikës së Kosovës
<b>PSh</b>	Prokurori i Shtetit
<b>PK</b>	Policia e Kosovës
<b>LS</b>	Integritet Seksual
<b>IPPF</b>	International Planned Parenthood Federation
<b>KEDNj</b>	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut

## Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive .....	5
2. Metodologjia .....	6
3. Korniza ligjore .....	7
4. Trajtimi i rasteve të integritetit seksual nga ana e policisë .....	8
5. Trajtimi i rasteve të integritetit seksual nga ana e prokurorisë .....	9
6. Trajtimi i rasteve të integritetit seksual nga ana e gjykatës .....	13
6.1. Trajtimi i rasteve të integritetit seksual nga ana e gjykatës, sipas veprave specifike ...	14
6.2. Mënyra e zgjidhjes së rasteve dhe politika ndëshkimore .....	16
7. Parashkrimi i rasteve të veprave penale kundër integritetit seksual .....	18
8. Kompensimi i viktimave të krimeve seksuale .....	19
9. Arsytimi i dënimeve nga gjykatat .....	21
10. Gjetjet tjera të IKD-së .....	22
11. Annex 1: Analizë e aktgjytimeve të veprave penale të integritetit seksual nga Gjykata Themelore gjatë viteve 2017-2019 .....	25
12. Annex 2: Analizë e aktgjytimeve me burgim me kusht për vepra penale kundër integritetit seksual .....	38
13. Annex 3: Analizë e aktgjytimeve me gjobë për vepra penale kundër integritetit seksual	39
14. Analizë e aktgjytimeve liruese për vepra penale kundër integritetit seksual .....	39
15. Analizë e aktgjytimeve të integritetit seksual nga Gjykata e Apelit .....	40
16. Analizë e aktgjytimeve të integritetit seksual nga Gjykata Supreme .....	43

## 1. Përmbledhje ekzekutive

Në rastin e veprave penale kundër integritetit seksual, nisur nga fakti i ndjeshmërisë së viktimave që janë të përfshirë në këto raste, kërkohet që sistemi i drejtësisë të veprojë me një efikasitet, efektivitet, profesionalizëm dhe kujdes të veçantë.

Problemet e vazhdueshme në sistemin kosovar të drejtësisë të cilat hasen edhe në fusha të tjera, krijojnë një problematikë të veçantë në rastin e veprave penale kundër integritetit seksual. Kjo pasi IKD ka gjetur se edhe në këto raste, sistemi kosovar i drejtësisë nuk ka proceduar me efikasitet në këto raste, dhe zvarritjet procedurale janë shfaqur vazhdimisht. Në këto raste, kjo zvarritje paraqet një rëndesë të veçantë për palët e dëmtuara në këto raste, që në shumicën e rasteve janë gra.

Sidoqoftë, IKD ka evidentuar raste të cilat kanë përfunduar me një shpejtësi maksimale, derisa ka gjetur edhe raste që janë zvarritur me vite.

Krahas zhvillimit të procesit penal, IKD ka gjetur se mënyra se si veprojnë gjykatat përkitazi me kërkesën pasurore juridike të palëve të dëmtuara në këto raste rëndon edhe më shumë pozitën e të njëjtave në një procedurë gjyqësore.

Kjo pasi në shumicën dërrmuese të rasteve, gjyqtarët në procedurë penale nuk vendosin edhe për kërkesën pasurore juridike, por se lidhur me këtë kërkesë, udhëzojnë palët në kontest civil. Krahas faktit se kjo mënyrë e veprimit paraqet ngarkim me lëndë për vetë gjykatat, një mënyrë e tillë e veprimit potencialisht mund të ndikojë dukshëm që palët e dëmtuara në këto raste të heqin dorë nga kërkesa e tyre pasurore juridike, nga

mungesa e gatishmërisë për tu përballur me një proces të ri gjyqësor, krahas atij tanimë të përfunduar.

IKD në këtë raport po ashtu ka gjetur se dukuria e parashkrimit nuk është e theksuar në masë të madhe në këto raste. Por se, IKD në këtë drejtim gjen se shqetësues është fakti se kjo dukuri ka pësuar ngritje vit pas viti.

Bazuar në rastet e pranuar nga Policia e Kosovës, IKD gjen se trendi i këtyre veprave penale nuk është stabil dhe varion vit pas viti. Por, ajo që bie në sy është se në vitin 2020, pjesa më e madhe e të cilit vit ka qenë përballje me pandeminë COVID-19, këto raste janë ngritur në masë të konsiderueshme.

Në anën tjetër, gjatë analizimit të aktgjykimeve lidhur me rastet e veprave penale kundër integritetit seksual, IKD ka gjetur se në këto raste gjykatat nuk japin arsyetim meritore ashtu siç kërkohet me Kodin Penal dhe Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore.

Përballë arsytimit të shumta që kërkohen sipas këtij udhëzuesi, gjykatat kryesisht dënimet i arsyetojnë përmes shablloneve të cilat përsëriten aktgjykim pas aktgjykimi.

IKD thekson faktin se secili dënim duhet të synoj arrijtjen e qëllimeve të parapara me ligj, arrijtja e të cilave dënime determinon edhe dënimin individual në një rast të caktuar. Me këtë rast, IKD vlerëson se kjo nuk mund të arrihet nëse në aktgjykimet e gjykatave, nuk ka arsyetim meritore për këtë pjesë.

## 2. Metodologjia

IKD në trajtimin e rasteve të veprave penale kundër integritetit seksual nga sistemi i drejtësisë, në mënyrë që të përpilojë një raport sa më gjithëpërfshirës dhe analitik, ka përdorur metodologji të përzier të hulumtimit.

Për draftimin e këtij hulumtimi, IKD ka përdorur dokumente të ndryshme zyrtare (legjislacionin primar dhe sekondar, raporte të ndryshme zyrtare të KGJK-së, KPK-së, PK-së etj. si dhe të dhëna të tjera të siguruar nga këto institucione përmes kërkesave për qasje në dokumente publike). Po ashtu, janë përdorur dokumente ndërkombëtare, të cilat janë të obligueshme dhe drejtpërdrejtë të zbatueshme në sistemin e drejtësisë.

Për shkak se rastet e veprave penale kundër integritetit seksual mbahen të mbyllura për publikun, draftimi i këtij raporti nuk është bazuar në monitorimin e drejtpërdrejt të këtyre rasteve, por se për këto raste IKD ka analizuar një numër të aktgjykimeve të cilat i ka siguruar në faqen zyrtare të gjykatave dhe përmes kërkesave për qasje në dokumente zyrtare.

Për draftimin e këtij raporti janë analizuar 56 aktgjykime të shpallura nga viti 2017 e deri më 31 dhjetor 2019, ku përfshihen

rastet e 76 personave ndaj të cilëve gjykatësit e të gjitha Gjykatave Themelore dhe degëve të saj kanë shpallur aktgjykime.

Po ashtu, IKD gjatë draftimit të këtij raporti ka zhvilluar edhe intervista me të gjithë hisedarët e sistemit të drejtësisë, të cilat intervista janë inkorporuar në këtë raport. Po ashtu, para publikimit, ky raport i është dërguar për komente të gjithë hisedarëve të sistemit të drejtësisë, si KGJK, KPK, Kryetarëve të Gjykatave, Kryeprokurorëve, Avokatëve etj.

### 3. Korniza ligjore

Integriteti seksual është e drejtë e njeriut dhe është e mbrojtur me kushtetutë dhe me akte të ndryshme ndërkombëtare. Këtë të drejtë të njeriut, shtetet e mbrojnë edhe me dispozita të karakterit penal. Kodi Nr.06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës në kapitullin e XX, ka përfshirë veprat kundër integritetit seksual dhe sanksionin që është paraparë nga ligjvënësi.

Integriteti i njeriut, në aspektin seksual, është i lënduar nëse në mes të raporteve të tij me një person tjetër, mungon një element crucial: “pëlqimi”. Këtë e ka paraparë edhe KPRK, me ç’rast ka përcaktuar se “vullnet individual për të kryer aktin seksual”. “KPPRK përcakton se “1. Shprehja “pëlqim” nënkupton: 1.1. pajtim i vullnetshëm i personit i cili ka arritur moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet për të kryer aktin seksual; 1.2. marrëveshja vullnetare e dy personave të cilët kanë arritur moshën katërmbëdhjetë (14) vjet dhe ku dallimi në moshën e tyre nuk tejkalon dy (2) vjet, për të kryer aktin seksual në fjalë”<sup>1</sup>. Sipas KPPRK-së, nuk ekziston pëlqimi nëse “personi i tillë me fjalë ose me sjellje shpreh mungesë të pajtimit për të kryer aktin ose për ta vazhduar atë; pajtimi është shprehur me fjalë ose me sjelljen e një personi tjetër dhe jo të viktimës; pajtimi i viktimës është marrë me mashtrim, frikësim ose me kërcënim, nëse mënyrat e tilla nuk përfshijnë përdorimin e forcës, kanosjes serioze ose shfrytëzimin siç është paraparë në nenin 227 paragrafi 3. të këtij Kodi; ose personi i tillë është i paaftë për të dhënë pajtimin për aktivitet seksual për shkak të aftësisë së zvogëluar mendore apo fizike

ose dehjes me alkool, drogë apo me substanca tjera”<sup>2</sup>.

Keqpërdorimi i integriteti seksual, si tërësi, mund të përfshijë vepra të natyrave të ndryshme penale, që mund të bien në kundërshtim me respektimin e tij. Dhunimi, është ndër veprat penale më të rënda, që ndikon në keqpërdorimin e integritetit seksual të viktimës, vepër kjo që sipas Kodit të ri Penal është e dënueshme prej 2 deri me burgim të përjetshëm.

Sipas Kapitulli XX të Kodit NR. 06/L-074 Penal të Kosovës, në kuadër të veprave penale, që cenojnë integritetin seksual hyjnë: “dhunimi”, “shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit”, “sulmi seksual”, “degradimi i integritetit seksual”, “ofrimi i materialit pornografik personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet”, “keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi”, “nxitja e akteve seksuale me premtim të rrejshëm të martesës”, “mundësimi ose detyrimi në prostitucion”, “ofrimi i lokaleve për prostitucion”, “marrëdhëniet seksuale brenda familjes”.

Sipas këtij Kodi, veprat penale “dhunimi”, “shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit”, “sulmi seksual” dhe “degradimi i integritetit seksual”, janë veprat penale më të dënueshme nga kapitulli i veprave penale kundër integritetit seksual, dënimi maksimal i të cilave shkon deri në burgim të përjetshëm. Pjesë e cenimit të integritetit seksual, është edhe vepra penale e ngacmimit seksual, të cilën e ka paraparë neni 183 i KPRK-së, e cila vepër sipas Kodit të Ri Penal, është e dënueshme me gjobë e deri me 5 vite burgim.


<sup>1</sup> Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës. Neni 225.1.

<sup>2</sup> Po aty. Neni 225.2.

#### 4. Trajtimi i rasteve të integritetit seksual nga ana e policisë

IKD përmes të dhënave të siguruara nga Policia e Kosovës përmes kërkesës për qasje në statistika, ka analizuar ngarkesën e këtij institucioni me raste të veprave penale kundër integritetit seksual.

Sipas këtyre të dhënave, përgjatë viteve 2017, 2018, 2019 dhe 2020, janë paraqitur gjithsej 434 raste të veprave penale kundër integritetit seksual. Ndërsa, për vitet 2017-2019, vërehet se për 266 persona janë ushtruar kallëzime penale.



Grafiku 1: Numri i rasteve të policisë me veprave penale kundër integritetit seksual gjatë viteve 2017-2020.<sup>3</sup>

Përgjatë katër (4) viteve, IKD gjen se PK-ja më së shumti lëndë të kësaj natyre ka pranuar gjatë vitit 2020. Përkatësisht, Policia e Kosovës në vitin 2017, ka pranuar 83 raste ku kanë qenë të përfshirë 92 persona.

Ky numër i rasteve është rritur për 23.9% në vitin 2018, gjatë të cilit vit Policia e Kosovës ka pranuar gjithsej 101 raste në të cilat janë përfshirë 114 persona, ndërkaq në vitin 2019, PK ka pranuar 52 raste të kësaj natyre, në të cilat raste kanë qenë të përfshirë 60 persona, apo 90% më pak se sa në vitin paraprak. apo numri i personave të përfshirë është zvogëluar për 90% apo 60 persona.

Por, viti 2020 shënon rritje drastike të rasteve që janë raportuar në polici me 198 raste apo 141 raste më shumë se në vitin 2019.

Sipas të dhënave të PK-së, për gjatë katër (4) viteve më së shumti lëndë nga kategoria e veprave penale kundër integritetit seksual janë paraqitur për “sulm seksual” dhe “dhunim”.

<sup>3</sup> Të dhëna të siguruara nga sistemi informativ i Policisë së Kosovës. 2 shkurt 2021.



<b>Veprat penale</b>	<b>2017</b>	<b>2018</b>	<b>2019</b>	<b>2020</b>	<b>Total</b>
<b>Dhunimi</b>	12	22	2	61	<b>121</b>
<b>Sulmi Seksual</b>	28	23	11	55	<b>132</b>
<b>Degradimi i integritetit seksual</b>	3	2	1	5	<b>12</b>
<b>Keqpërdorimi seksual i personave me çrregullime ose paaftësi mendore apo emocionale</b>	1	/	1	5	<b>7</b>
<b>Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjeç</b>	30	46	15	/	<b>76</b>
<b>Nxitja e akteve seksuale, prekjes apo alternativave nga personat nën moshën 16 vjeç</b>	/	1	1	1	<b>2</b>
<b>Keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi</b>	4	2	0	5	<b>12</b>
<b>Keqpërdorimi seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin apo profesionin</b>	1	1	/	/	<b>2</b>
<b>Nxitja e akteve seksuale me premtim të rrejshëm të martesës</b>	1	1	1	1	<b>4</b>
<b>Mundësimi ose detyrimi në prostitucion</b>	3	2	/		<b>5</b>
<b>Ofrimi i lokaleve për prostitucion</b>	/	1	/	10	<b>11</b>
<b>Ngacmimi seksual</b>	/	/	/	48	<b>/</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>83</b>	<b>101</b>	<b>57</b>	<b>193</b>	<b>434</b>

**Tabela 1: Ngarkesa e PK-së me vepra penale kundër I.S gjatë periudhës 2017-2020**

## **5. Trajtimi i rasteve të integritetit seksual nga ana e prokurorisë**

Lidhur me veprat penale kundër integritetit seksual, PSh më së shumti lëndë në punë ka pasur në vitin 2017, me gjithsej 234 lëndë ku përfshihen 336 persona, prej të cilave i ka zgjidhur 138 raste ndaj 188 personave apo 59% të lëndëve, ndërsa i kanë mbetur të pazgjidhura 96 raste ndaj 148 personave apo 41% të lëndëve.

Në vitin 2018 PSh ka pasur më pak lëndë të në punë se sa në vitin 2017. Përkatësisht, gjatë vitit 2018, PSh ka pasur në punë 181 lëndë në të cilat kanë qenë të përfshirë 228 persona, prej të cilave Prokurori i Shtetit i ka zgjidhur 108 raste ndaj 113 personave apo 60% të lëndëve, ndërsa i kanë mbetur


të pazgjidhura 73 raste ndaj 133 personave apo 40% të rasteve.<sup>4</sup>

Në vitin 2019, PSh ka pasur në punë 208 raste me 303 persona, prej të cilave i ka zgjidhur 133 raste me 168 persona, që në përqindje i bie se në 2019, janë zgjidhur 64% e rasteve, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 75 raste ndaj 157 personave, apo 36% e lëndëve.<sup>5</sup>

Në vitin 2020, PSh ka pasur në punë 195 raste prej të cilave i ka zgjidhur 108 apo 55%, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 87 apo 45%.

Pra, sipas këtyre statistikave vërehet se PSh vit pas viti ka rritur efikasitetin e zgjidhjes së kësaj kategorie të veprave penale, pasi në vitin 2017 ka zgjidhur 59% të rasteve, në 2018 60% ndërsa në 2019 64%.<sup>6</sup>

Mirëpo, në vitin 2020 vërehet se ka pasur përqindje më të ulët të lëndëve të zgjidhura, pra me 9% më pak lëndë të zgjidhura se në vitin 2019. Por, duhet theksuar faktin se puna e Prokurorit të Shtetit gjatë vitit 2020 është influencuar edhe nga masat e ndërmarra si rezultat i situatës së krijuar nga pandemia COVID-19.



**Grafika 2: Ngarkesa e PSh-së me lëndë të I.S gjatë periudhës janar 2017-dhjetor 2020<sup>7</sup>**

IKD përpos ngarkesës më lëndë të veprave penale kundër integritetit seksual ka

analizuar edhe mënyrën e zgjidhjes së këtyre rasteve.

<sup>4</sup> *Shënim:* Të dhënat e dërguara nga Prokurori i Shtetit nuk përputhen pasi nëse gjatë vitit 2018 PSh ka qenë e ngarkuar me lëndë të 228 personave ndërsa nëse i kanë zgjidhur rastet e 113 personave, atëherë sipas llogaritjeve del se kanë mbetur të pazgjidhura rastet e 115 personave e jo 133 personave ashtu siç paraqitet në statistikat e KPK-së.

<sup>5</sup> *Shënim:* Edhe statistikat për vitin 2019, të dërguara nga KPK vërehet se kanë mospërputhje, pasi nëse gjatë vitit 2018, PSh ka qenë e ngarkuar me lëndë të 303 personave ndërsa nëse i kanë zgjidhur rastet e

168 personave, atëherë sipas llogaritjeve del se kanë mbetur të pazgjidhura rastet e 165 personave e jo 157 personave ashtu siç paraqitet në statistikat e KPK-së.

<sup>6</sup> Të dhëna të siguruara përmes kërkesës për qasje në të dhënat statistikore nga zyra e statistikave të Prokurorit të Shtetit. z.Valdrin Krasniqi. 12 shkurt 2021.

<sup>7</sup> Të dhëna të siguruara përmes kërkesës për qasje në të dhënat statistikore nga zyra e statistikave të Prokurorit të Shtetit. z.Valdrin Krasniqi. 29 maj 2020.

Sipas këtyre statistikave vërehet se në vitin 2017, në 37 raste kanë pushuar hetimet, në vitin 2018 në 24 raste dhe në vitin 2019 në 33 raste.

Sipas kësaj, vërehet se ekziston një numër i konsiderueshëm i rasteve ndaj të cilave kanë pushuar hetimet, duke mos iu nënshkruar asnjë kontrolli gjyqësor, pasi KPPRK në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës nuk ka garantuar kontroll gjyqësor ndaj akteve prokuroriale.

Lidhur me pushimin e hetimeve, IKD ka kërkuar sqarime nga kryeprokurorët e PTh-ve, mirëpo asnjë prej tyre nuk ka dhënë përgjigje se pse ekziston numër i madh i rasteve që kanë përfunduar me pushim të hetimeve.

*“Sipas kërkesës suaj, në emër të Kryeprokurorit z. Kadriu, ju njoftojmë se në Prokurorinë Themelore në Gjilan, sa i përket rasteve nga kapitulli ‘Veprat penale kundër integritetit seksual’, për vitet 2017, 2018 dhe 2019, të gjitha rastet e proceduara janë zgjidhur, me ç’rast janë ngritur aktakuza, janë propozuar masa edukative institucionale, ndërsa në rastet kur nuk ka ekzistuar dyshimi i arsyeshëm se janë kryer vepra penale të kësaj natyre janë pushuar hetimet apo janë hudhur kallëzimet penale. Ndërsa, sa i përket shqiptimit të dënimeve për këto vepra penale është kompetencë e gjykatës dhe në të gjitha rastet kur është vlerësuar se dënimi i shqiptuar është i ulët, Prokuroria Themelore në Gjilan ka paraqitur ankesa kundër aktgjykimeve”,* thuhet në përgjigjen e PTh në Gjilan.<sup>8</sup>

<sup>8</sup> Përgjigja e kryeprokurorit të PTh në Gjilan, Arben Kadriu. 19 shkurt 2021.

Ndërsa, në përgjigjen e PTh në Gjakovë thuhet se:

*“Më 06.02.2019, është ngritur një (1) aktakuzë kundër një personi, për veprën penale ‘Keqpërdorim i personave nën moshën 16 vjeçare’, nga neni 235. Ku për të njëjtin rast është shqiptu aktgjykimi fajësues nga Gjykata kompetente, më 11.09.2020 me 3 vite burgim. Më 14.10.2020 është ngritur një (1) aktakuzë kundër një personi, për veprën penale ‘Dhunimi’, neni 227, paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK. Ku për të njëjtin rast është shqiptu aktgjykimi fajësues nga Gjykata kompetente, më 10. 02.2021, me 3 vite burgim”<sup>9</sup>.*

Ndërsa, PTh-të tjera nuk kanë dërguar përgjigje.

IKD ka kërkuar nga KPK edhe të dhëna për secilën vepër penale kundër integritetit seksual, mirëpo sipas zyrës për statistika, KPK nuk gjeneron të dhëna të detajuara për secilën vepër penale veç e veç, prandaj është pamundësuar të analizohen efikasiteti i prokurorisë për secilën kategori të këtyre veprave penale, ashtu siç është bërë në rastin e Policisë së Kosovës dhe gjykatave.

Sikurse në rastet e tjera, IKD vlerëson se mos gjenerimi i të dhënave të detajuara statistikore për kapituj të caktuar të veprave penale paraqet një problematikë të theksuar brenda sistemit prokurorial. Kjo pasi mungesa e këtyre të dhënave i pamundëson këtij sistemi që problematikave specifike të një kategorie të veprave penale, në rastin konkret veprave penale kundër integritetit seksual, ti qaset në mënyrë të detajuar dhe

<sup>9</sup> Përgjigja e Zyrtarit për Komunikim dhe Monitorim të mediave në PTh në Gjakovë, Yllka Juniku-Shehu. 23 shkurt 2021.

të ndërmarrë masa me kohë. Andaj, IKD i rikujton sistemit prokurorial se përkundër nevojës që publiku të informohet në detaje mbi punën e Prokurorit të Shtetit, gjenerimi i të dhënave të detajuara statistikore është detyrë e domosdoshme për ngritjen e administrimit të mirë të drejtësisë.

Në tabelën në vijim, janë paraqitur të dhëna mbi mënyrën e zgjidhjes së rasteve të integritetit seksual nga ana e Prokurorit të Shtetit gjatë viteve 2017-2020.

	<b>Aktakuzë e drejtpërdrejt</b>	<b>Aktakuzë me kërkesë për Urdhër ndëshkimor</b>	<b>Pezullim i hetimeve</b>	<b>Pushim i hetimeve</b>	<b>Aktakuzë pas procedurës hetimore</b>	<b>Total</b>
<b>2017</b>	18	3	0	37	100	<b>158</b>
<b>2018</b>	2	1	0	24	57	<b>84</b>
<b>2019</b>	7	0	0	33	97	<b>137</b>
<b>2020</b>	3	0	1	12	83	<b>99</b>
<b>Total</b>	<b>30</b>	<b>4</b>	<b>1</b>	<b>106</b>	<b>337</b>	

**Tabela 2: Mënyra e zgjidhjes së lëndëve të veprave penale të I.S nga prokurorët për periudhën janar 2017-dhjetor 2020.<sup>1011</sup>**

<sup>10</sup> Të dhëna të siguruar përmes kërkesës për sigurimin e të dhënave nga zyra e statistikave të Prokurorit të Shtetit, z.Valdrin Krasniqi me 12 shkurt 2021.

<sup>11</sup> Shënim: Statistikat e dërguara nga KPK me anë të kërkesës për qasje në dokumente zyrtare nuk përputhen, pasi statistikat në lidhje me numrin e lëndëve të zgjidhura me statistikat e mënyrës së zgjidhjes së lëndës kanë mos përputhje të madhe.

P.sh nëse gjatë vitit 2017, PSh ka zgjidhur 138 lëndë, tek mënyra e zgjidhjes së lëndës figuron se janë zgjidhur 18 raste me aktakuzë të drejtpërdrejtë, 3 me aktakuzë me kërkesë për urdhër ndëshkimor, 37 me pushim të hetimeve, 100 me aktakuzë pas procedurës hetimore, që në total i bie 158 raste. E njëjta mos përputhje figuron edhe në statistikat e viteve 2018, 2019 dhe 2020.

## **Rekomandime:**

1. Prokurori i Shtetit, të rrisë numrin e prokurorëve dhe të bëj specializimin e disa prokurorëve në të gjitha prokuroritë, të cilët do të trajtonin me theks të veçantë lëndët e veprave penale të integritetit seksual.
2. Prokurori i Shtetit, të rrisë efikasitetin e zgjidhjes së lëndëve të cenimit të integritetit seksual.
3. KPK të gjenerojë të dhënave statistikore të detajuara lidhur me veprat penale kundër integritetit seksual.
4. Ministria e Drejtësisë me rastin e draftimit të Kodit të ri të Procedurës Penale, të ketë parasysh garantimin e kontrollit gjyqësor ndaj akteve prokuroriale.

## **6. Trajtimi i rasteve të integritetit seksual nga ana e gjykatës**

4.5 % e totalit të veprave penale me të cilat DKR-të e GjTh-ve kanë qenë të ngarkuara gjatë vitit 2017 e përbëjnë veprat penale kundër integritetit seksual. Kjo përqindje në vitin 2018 është ngritur në 4.9% ndërsa në vitin 2019 është ngritur sërish në 5.2%.

Sipas të dhënave nga raportet vjetore, DKR-të e GjTh-ve gjatë vitit 2017, kanë trashëguar nga viti paraprak rreth 214 lëndë lidhur me veprat penale kundër integritetit seksual, kanë pranuar 63 lëndë të reja, dhe gjithsej në punë kanë pasur 277 lëndë të veprave kundër integritetit seksual.

Në total, këto gjykata kanë arritur të zgjidhin vetëm 77 lëndë apo 27.7%, kurse 196 lëndë apo 70.7% prej tyre kanë mbetur të pazgjidhura si dhe katër (4) lëndë apo 1.4% janë dërguar në kompetencë brenda gjykatës.

Sa i përket vitit 2018, DKR-të e GjTh-ve kanë trashëguar nga viti paraprak 196 lëndë të kësaj natyre, i kanë pranuar 73 lëndë të reja dhe gjithsej në punë kanë pasur 269 lëndë prej të cilave 72 lëndë apo 24.1% janë zgjidhur, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 196 apo 65.7%, si dhe vetëm një (1) lëndë apo 0.33% është dërguar në kompetencë brenda gjykatës në këtë vit.


Ndërsa gjatë viti 2019, në të gjitha gjykatat themelore DKR-të kanë trashëguar 195 lëndë nga viti paraprak, i kanë pranuar 56 lëndë të reja dhe gjithsej në punë kanë pasur 251 lëndë, prej të cilave 91 lëndë apo 36% janë zgjidhur, ndërsa 156 lëndë apo 62.1% kanë mbetur të pazgjidhura si dhe katër (4) lëndë apo 1.5% janë dërguar në kompetencë brenda gjykatës.

IKD ka gjetur se nga lëndët e pranuar në vitin 2017 (63), DKR-të e gjykatave kanë arritur t'i zgjidhin 77 lëndë, përkatësisht 14 lëndë më shumë se që kanë pranuar.

Në vitin 2018, DKR-të kanë zgjidhur një lëndë më pak se sa që kanë pranuar, ndërsa në vitin 2019, DKR-të kanë zgjidhur 35 lëndë më shumë se sa që kanë pranuar, pasi që kanë pranuar 56 lëndë ndërsa kanë zgjidhur 91 sosh. Pra gjatë këtij viti vërehet një ngritje e efikasiteti të gjykatave në zgjidhjen lëndëve të kësaj natyre<sup>12</sup>.

<sup>12</sup> Shënim: IKD ka kërkuar vazhdimisht qasje edhe në statistikat e gjykatave për vitin 2020, por se të

njëjtit kanë thënë se për vitin 2020, ende nuk janë gjeneruar këto statistika nga gjykatat.



**Grafika 3: Numri i lëndëve kundër integritetit seksual në DKR-të e gjykatave themelore për vitet 2017, 2018 dhe 2019.**

### 6.1. Trajtimi i rasteve të integritetit seksual nga ana e gjykatës, sipas veprave specifike

IKD ka analizuar edhe ngarkesën e GjTh-ve sipas veprave penale specifike kundër integritetit seksual gjatë viteve 2017-2019.

Sipas të dhënave të siguruar nga KGJK, vërehet se vepra penale “**dhunimi**” bën pjesë me numrin më të madh të lëndëve, krahas veprave tjera penale që janë pjesë e kësaj kategorie të KPPRK. Pas saj radhitet vepra penale “*Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjet*” dhe vepra penale “*sulmi seksual*”.

Ndërsa, sipas të dhënave të raporteve vjetore të gjykatave, rezulton se për veprat penale “*Ofrimi i materialeve pornografike personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet*” dhe “*Ofrimi i lokaleve për prostitucion*”, nuk ka asnjë lëndë.

Mirëpo, në aktgjykimet e analizuara rezulton se ekzistojnë edhe raste për veprën penale “*ofrimi i lokaleve për prostitucion*”.

Kjo e dhënë paraqet faktin se raportet vjetore të gjykatave nuk paraqesin tablo reale të të gjitha rasteve të veprave penale kundër integritetit seksual.

Në anën tjetër, IKD ka gjetur se edhe pse ka më së shumti raste për veprën penale “*dhunimi*”, gjykatat nuk kanë treguar efikasitet në zgjidhjen e këtyre rasteve, për shkak se gjatë vitit 2017 nga 142 lëndë në punë, gjykatat kanë zgjidhur vetëm 20% të rasteve, gjatë vitit 2018 nga 135 lëndë në punë, gjykatat kanë zgjidhur 27% të rasteve, derisa gjatë vitit 2019, nga 119 lëndë në punë ka pasur ngritje të rasteve të zgjidhura në 40%.

Mirëpo, sipas këtyre të dhënave vërehet se vit pas viti gjykatat kanë qenë më pak të ngarkuara me lëndë të kësaj kategorie.

Edhe për veprën penale “*Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjet*”, për të cilën vepër penale shihet se ka numër të madh të rasteve, vërehet se në përqindje nuk janë zgjidhur shumë lëndë, pasi në vitin 2017, janë zgjidhur 36% e këtyre lëndëve,

në 2018 është ulur përqindja e lëndëve të zgjidhura për këtë vepër penale, pasi janë zgjidhur vetëm 29% e tyre, ndërsa në vitin 2019, të dhënat tregojnë se ka pasur rritje të përqindjes së lëndëve të zgjidhura për këtë vepër penale, pasi janë zgjidhur 41% të lëndëve.

Ndërsa për veprën penale “*sulmi seksual*”, e cila radhitet e treta për nga numri i

lëndëve, vërehet se gjykatat gjatë vitit 2017, me gjithsej 32 lëndë në punë kanë arritur të zgjidhin 25% të këtyre lëndëve, në vitin 2018 nga gjithsej 32 lëndë në punë gjykatat kanë arritur të zgjidhin 28% të lëndëve nga kjo kategori e veprave penale, ndërsa në vitin 2019, nga 34 lëndë në punë, gjykatat kanë arritur të zgjidhin 29% të këtyre rasteve.

Ngarkesa e gjykatave me lëndë	Lëndë në punë			Të zgjidhura			Të pazgjidhura		
	2017	2018	2019	2017	2018	2019	2017	2018	2019
<b>Vitet</b>									
<b>Dhunimi</b>	142	135	119	29	37	48	110	97	70
<b>Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjet</b>	72	70	63	26	20	26	45	50	35
<b>Sulmi Seksual</b>	32	32	34	8	9	10	24	23	23
<b>Mundësimi apo detyrimi në prostitucion</b>	6	8	10	4	1	4	4	7	6
<b>Keqpërdorimi seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin apo profesionin</b>	6	7	6	0	1	2	6	6	4
<b>Keqpërdorimi seksual i personave me çrregullime ose paaftësi mendore apo emocionale</b>	9	5	5	6	2	0	3	3	5
<b>Shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit</b>	4	4	4	1	0	0	3	4	4
<b>Keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi</b>	3	4	3	1	1	0	2	3	3
<b>Degradimi i integritetit seksual</b>	0	1	1	0	1	0	0	0	1
<b>Marrëdhënia seksuale brenda familjes</b>	2	1	1	1	0	0	1	1	1
<b>Nxitja e akteve seksuale me premtim të rrejshëm të martesës</b>	0	1	2	0	0	1	0	1	1
<b>Nxitja e akteve seksuale, prekjes apo aktiviteteve nga personat nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet</b>	1	1	1	1	0	0	0	1	1
<b>Përkufizimet lidhur me veprat penale kundër integritetit seksual</b>	0	0	1	0	0	0	0	0	1


Lajtimi në fakt lidhur me moshën e viktimës”	0	0	1	0	0	0	0	0	1
Ofrimi i materialeve pornografike personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Ofrimi i lokaleve për prostitucion	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Total	277	269	251	77	72	91	198	196	156

Tabela 3: Ngarkesa e gjykatave me lëndë të integritetit seksual gjatë tri viteve.

## 6.2. Mënyra e zgjidhjes së rasteve dhe politika ndëshkimore

Sipas të dhënave statistikore të KGJK-së, IKD ka gjetur se në rastet e veprave penale kundër integritetit seksual, Gjykatat më së shpeshti kanë shqiptuar dënime me burgim efektiv. Në tabelën në vijim janë paraqitur

të dhëna të detajuar sa i përket mënyrës së zgjidhjes së rasteve dhe politikës ndëshkimore sipas veprave specifike penale kundër integritetit seksual:



Grafika 4: Mënyra e zgjidhjes së lëndëve të integritetit seksual nga gjykatat gjatë viteve 2017-2019.

Lidhur me politiken ndëshkimore, si dhe për parashkrimin e rasteve, IKD ka kërkuar sqarime nga shtatë (7) kryetarët e GjTh-ve, mirëpo sipas tyre, ata nuk mund ti komentonin mënyrën e vendosjes nga ana e gjyqtarëve.

Kryetari në detyrë në GjTh në Prizren, Artan Sejrani, në përgjigjen e dhënë për IKD, ka thënë se nuk mund të komentojë rreth politikës ndëshkimore për mënyrën e vendosjes nga ana e gjyqtarëve për secilin rast individual.



*“Kryetari në detyrë i Gjykatës Themelore në Prizren Artan Sejrani, nuk mund të komentojë rreth politikës ndëshkimore për mënyrën e vendosjes nga ana e gjyqtarëve për secilin rast individual, duke marrë parasysh faktin se gjyqtarët vendosin në bazë të bindjes së lire, dhe duke respektuar parimet e pavarësisë dhe paanshmërisë...secili rast gjykohet dhe vendoset individualisht dhe secili rast është i veçantë për nga natyra e punës”, thuhet në përgjigjen e kësaj gjykate.*<sup>13</sup>

Njëjtë kishte deklaruar edhe kryetari i GjTh në Gjilan, Ramiz Azizi.

*“Ne nuk mund të komentojmë vendimet e gjykatave të tjera, gjithashtu siç e dini sistemi gjyqësor i Kosovës është sistem i shkallëshmërisë, ku vendimet e gjykatës së shkallës së parë mund të atakohen dhe është shkalla e dytë dhe ajo e tretë, të cilat janë kompetente për të vërtetuar, ndryshuar apo prishur një vendim, në qoftë se është shqiptuar dënim i ulët dhe nuk jemi ne kompetentë për këtë”, thuhet në përgjigjen e GjTh në Gjilan.*<sup>14</sup>

Edhe, GjTh në Ferizaj ka dhënë pothuajse të njëjtën përgjigje.

*“Gjyqtarët punën e tyre profesionale, përkatësisht vendosjen e një çështje gjyqësore, e kryejnë sipas bindjes së tyre të lirë dhe duke respektuar parimet që dalin nga ligjet në fuqi për paanshmëri dhe pavarësi, ndërsa për pyetjet e tjera, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me komentimin/vlerësimin rreth arsytimit, parashkrimin dhe të tjera, nuk është në juridiksionin e kryetarit të gjykatës të vlerësoj nëse një aktgjykim është i përpiluar, arsytuar mirë dhe të tjera, nga gjyqtari i çështjes, pasi të njëjtat mund të atakohen përmes mjeteve të rregullta juridike në procedurën ankimore si në shkallë të dytë ashtu edhe në shkallën e tretë, dhe është në kompetencë të gjykatave të shkallës më të lartë të vlerësoj të lartshënuarat”, thuhet në përgjigjen e GjTh në Ferizaj.*

Ndërsa, kryetarët e gjykatave tjera nuk kanë kthyer përgjigje.

Në tabelën në vijim, janë paraqitur të dhëna të detajuara mbi mënyrën e zgjidhjes së rasteve nga gjykatat, sipas secilës vepër penale në kuadër të veprave penale kundër integritetit seksual.

---

<sup>13</sup> Përgjigja e kryetarit të GjTh në Prizren, Artan Sejrani. 22 shkurt 2021.

<sup>14</sup> Përgjigja e kryetarit të GjTh në Gjilan, Ramiz Azizi, 23 shkurt 2021.

	Dënime me burgim			Dënime me gjobë			Dënime me kusht			Aktgjyime liruese			Aktgjyime refuzuese		
	2017	2018	2019	2017	2018	2019	2017	2018	2019	2017	2018	2019	2017	2018	2019
<b>Dhunimi</b>	9	8	9	2	2	3	4	4	5	4	8	10	4	8	15
<b>Shërbimet seksuale të viktimit të krimit</b>	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Sulmi seksual</b>	2	0	3	2	1	0	0	2	0	3	0	0	1	2	3
<b>Degradimi i integritetit seksual</b>	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Keqpërdorimi seksual i personave me çrregullime apo paaftësi mendore apo emocionale</b>	9	1	0	4	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0
<b>Keqpërdorimi seksual i personave nën 16 vjeç</b>	10	6	14	6	2	1	6	7	4	1	2	4	2	1	1
<b>Nxitja e akteve seksuale, prekja apo aktiviteteve nga personat nën 16 vjet</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0
<b>Ofrimi i materialeve pornografike personave nën 16 vjet</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi</b>	0	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Keqpërdorimi seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin apo profesionin</b>	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	1	0	0	0
<b>Nxitja e akteve seksuale me premtim të rrejshëm të martesës</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
<b>Mundësimi ose detyrimi në prostitucion</b>	2	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	2
<b>Ofrimi i lokaleve për prostitucion</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Marrëdhëniet seksuale brenda familjes</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Total</b>	<b>32</b>	<b>7</b>	<b>18</b>	<b>13</b>	<b>5</b>	<b>2</b>	<b>7</b>	<b>10</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>4</b>	<b>6</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>6</b>

Tabela 4: Mënyra e zgjidhjeve të lëndëve kundër I.S për vepra penale specifike për periudhën 2017-2019.

## 7. Parashkrimi i rasteve të veprave penale kundër integritetit seksual

Parashkrimi i veprave penale përveç që amnistion kryesit e veprave penale dëmton veçanërisht edhe interesat e palëve të dëmtuara, si dhe parandalon efektin e sistemit të drejtësisë në arritjen e qëllimit kryesor të dënimit, që është parandalimi i përgjithshëm i kriminalitetit.

Nisur nga ndjeshmëria e viktimave sa i përket rasteve të veprave penale kundër

integritetit seksual, pasoja e palëve të dëmtuara në këtë rast është shumë më e theksuar se sa në rastet e tjera.

Sipas të dhënave nga raportet vjetore të gjykatave, gjatë vitit 2017 nga kapitulli i veprave penale kundër integritetit seksual, me parashkrim absolut ka përfunduar një (1) rast, në vitin 2018 dy (2) raste (1 absolut, 1 relativ), ndërsa në vitin 2019, janë parashkruar shtatë (7) raste (2 absolut dhe 5 relativ).

Edhe pse për këtë kategori të veprave penale numri i rasteve të parashkuara nuk është i madh, shqetësuese mbetet rritja e numrit të rasteve vit pas viti.

Veçanërisht, shqetësues është fakti se në vitin 2017, rasti i vetëm i parashkuar është për veprën penale “*dhunimi*”. Po ashtu, edhe dy (2) rastet e parashkuara gjatë vitit 2018, kanë të bëjnë me veprën penale të dhunimit.

Ndërsa, në vitin 2019 janë parashkuar gjithsej katër (4) raste të dhunimit (3 parashkrim relativ dhe 1 parashkrim absolut) dhe tri (3) raste të sulmit seksual (2 parashkrim relativ dhe 1 parashkrim absolut).



**Grafika 5: Numri i rasteve të parashkuara për veprat penale kundër I.S gjatë viteve 2017-2019**

Në këtë drejtim, sikurse në fushat e tjera gjyqësore<sup>15</sup>, parashkrimi i veprave penale kundër integritetit seksual paraqitet si një sfidë për sistemin e drejtësisë, e cila në

<sup>15</sup> *Shënim:* Çështja e parashkrimit është evidentuar edhe në raportet e kaluara të IKD-së. Në raportin e publikuar në qershor 2020, me titull “*Lufta për statistika të korrupsionit*”, theksohet se 7 raste të korrupsionit janë mbyllur për shkak të parashkrimit absolut. (Shih linkun <https://kli-ks.org/lufta-per-statistika-te-korrupsionit/>) (Qasur për herë të fundit më 11 mars 2021); Edhe në raportin “*Krimet e Rënda në Kosovë, ligji VS praktika*”, theksohet se për 18 muaj janë parashkuar 67 lëndë. (Shih linkun <https://kli-ks.org/ikd-rritja-e-numrit-te-gjyqtareve-ne-departamentet-e-krimave-te-renda-pa-rezultat-ne->

mënyrë të ligjshme amnistion kryerësit eventual nga përgjegjësia penale, cenon të drejtat e palëve të dëmtuara, parandalon arritjen e qëllimeve të dënimit si dhe ndikon në uljen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

Në këtë drejtim, problematike mbetet qasja pasive e KGJK-së për të marrë masa konkrete për uljen e numrit të rasteve të parashkuara dhe për të mbajtur llogaridhënës gjyqtarët, rastet e të cilëve parashkruhen për shkaqe subjektive.

### **Rekomandime:**

1. Kryetarët e Gjykatave në bashkëpunim me gjyqtarët të përpilojnë regjistra të rasteve të cilat rrezikojnë të parashkruhen brenda një afati të shkurtër kohor.
2. Gjyqtarët t’iu japin prioritet rasteve të cilat rrezikojnë parashkrimin, në mënyrë që mos të lejojnë që lëndë të cilat hyjnë në kuadrin e veprave penale kundër integritetit seksual të arrijnë parashkrimin.

## **8. Kompensimi i viktimave të krimeve seksuale**

IKD në 56 aktgjykimet e analizuara ka gjetur se vetëm në një (1) rast gjykata e

[ngritjen-e-efikasitetit-gjykates-me-shume-lende-me-pak-te-pranuara-lende-me-pak-te-zgjidhura/](#)). (Qasur për herë të fundit më 11 mars 2021); Ndërsa në raportin “*Krimet e përgjithshme në Kosovë, ligji vs praktika*”, thuhet se për një vit e gjysmë, në sistemin gjyqësor janë parashkuar 4,112 “krime” të përgjithshme (3,850 lëndë me parashkrim absolut dhe 262 lëndë me parashkrim relativ). (Shih linkun <https://kli-ks.org/ikd-shqetesuese-dukuria-e-parashkrimit-te-lendeve-ne-departamentet-e-pergjithshme-ne-divizionin-penal/>). (Qasur për herë të fundit më 11 mars 2021).

kishte obliguar të akuzuarin që të dëmtuarës në emër të kërkesës pasurore-juridike t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar në vlerë prej 2,500 euro, ndërsa në të gjitha rastet tjera pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil.

Vendosja e kësaj forme nga gjykatësit ndikon direkt në hezitimin e palëve të dëmtuara për të kërkuar dëmshpërblimin i cili iu takon. Zgjatja e procedurave është ajo që i bën skeptik palët për kërkimin/realizimin e një të drejte të garantuar me ligj.

Fakti se përgjatë një procedure penale një viktimë duhet të përballet në gjykim me ndjenjën e dhimbjes së shkaktuar, është tregues i mjaftueshëm që gjyqtarët ta kenë parasysh rëndësinë e vendosjes në procedurë penale edhe sa i përket kërkesës pasurore-juridike, në mënyrë që pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës-pasurore juridike mos të kushtëzohet edhe me një procedurë tjetër gjyqësore.

E gjithë kjo me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të viktimave, që në këto raste janë viktimat të ndjeshme.

IKD në aktgjykimet e analizuara ka vërejtur edhe raste kur viktimat ka hequr dorë nga kërkesa pasurore-juridike, e që si shkaktarë i kësaj mund të jetë mos gatishmëria për tu përballur dhe maltretuar në një proces tjetër për të realizuar këtë të drejtë. Kjo pasi për shkak të ndjeshmërisë së këtyre rasteve, viktimat hezitojnë për të kërkuar këtë të drejtë, vetëm e vetëm që të mos përballet edhe njëherë me drejtësinë.

Në rastet kur viktimat e këtyre rasteve nuk kompensohen nga gjykata në procedurë penale, ato obligohen të kërkojnë të drejtën e tyre në një proces të ri gjyqësor civil.

Ky rast civil i cili vije pas përfundimit të procedurës penale, në sistemin e drejtësisë konsiderohet si rast i ri, i cili trajtohet sipas datës së arritjes në gjykatë, dhe se epilogu i këtij rasti mund të zgjasë me vite.<sup>16</sup>

Në këtë mënyrë, fakti i ndjeshmërisë së viktimave të përfshira në këto raste dhe trajtimin në këtë mënyrë të kërkesave pasurore juridike të palëve të dëmtuara të përfshira në këto raste ndikon seriozisht që palët të heqin dorë nga kërkesa pasurore juridike dhe në këtë mënyrë, të cenohet direkt interesi juridik i tyre.

Për më tepër, kjo mënyrë e veprimit ndikon edhe në ngarkesën e sistemit gjyqësor me lëndë, nëse potencialisht viktimat kërkon kompensim përmes padisë civile.

### **Rekomandime:**

1. Gjykatat me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit të vendosin edhe lidhur me kërkesën pasurore juridike të palës së dëmtuar, me përjashtim të rasteve kur vendosja lidhur me këtë kërkesë prolongon seriozisht procedurën penale.

<sup>16</sup> Në raportin e publikuar në nëntor 2020 me titull “*Drejtësia Civile 2019*”, IKD ka gjetur se qytetarët duhet të presin me vite për zgjidhjen e lëndëve civile dhe se disa gjyqtarë tregojnë qasje selektive dhe

trajtim të pabarabartë të palëve. (Shih linkun <https://kli-ks.org/drejtësia-civile-2019/>).

## 9. Arsyetimi i dënimeve nga gjykatat

Në aktgjykimet e analizuara IKD ka gjetur se arsyetimet e aktgjykimeve nuk dallojnë shumë nga njeri tjetri dhe në disa raste duket se gjykata përdorin metodën “copy-paste”, për ti arsyetuar dënimet e shqiptuara.

Në këto aktgjykime, gjykatat bazohen në nenin 73 të KPRK, i cili parasheh rrethanat lehtësuese dhe rënduese, ndërsa në çdo arsyetim të aktgjykimit, në rastet e shqiptimit të dënimit thuhet se me një dënim të tillë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-së.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës, në nenin 73, përcakton rregullat e përgjithshëm për matjen e dënimit nga ana e gjykatës. Sipas këtij neni, me rastin e caktimit të dënimit, gjykata duhet të ketë parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për atë vepër penale, pastaj duhet të merr parasysh qëllimin e dënimit, parimet e përcaktuara në këtë kapitull dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese lidhur me veprën penale të caktuar ose me dënimin.

Sa i përket politikës ndëshkimore, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës më 15 shkurt 2018 ka miratuar *Udhëzuesin për Politikë Ndëshkimore*, i cili udhëzues paraqet udhëzime të detajuara dhe praktike se si gjyqtarët duhet të veprojnë në secilin rast, varësisht specifikave të rastit.

Por se, përkundër një numri të madh të arsyetimeve që sipas Udhëzuesit për Politikë Ndëshkimore kërkohet të ipen në secilin rast, IKD ka gjetur se është pothuajse e kundërta në rastet e

aktgjykimeve për veprat penale kundër integritetit seksual. Kjo pasi se arsyetimet e gjykatave janë të një karakteri të përgjithshëm dhe përshtues, dhe nuk e bëjnë të qartë për palët dhe publikun se pse brenda një minimumi dhe maksimumi të caktuar ligjor, është shqiptuar pikërisht dënimi si në dispozitivin e një aktgjykimi të caktuar.

Përveç arsyetimit mbi caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, KPPRK ka përcaktuar se si gjykata e konsideron përgjegjës të pandehurin duke përfshirë citimin e provave materiale, deklaratat e dëshmitarëve dhe mbrojtjen e të akuzuarve. Por se, nga aktgjykimet e analizuara, IKD ka gjetur se këto çështje nuk arsyetohen në aktgjykimet e nxjerra, por se këto çështje trajtohen vetëm duke cituar “copy-paste” procesverbalet dhe provat e tjera të administruara gjatë procedurës penale, por se jo edhe duke dhënë arsyetime specifike dhe të detajuara mbi vërtetimin dhe mos vërtetimin e secilit fakt dhe pretendim të ngritur gjatë zhvillimit të një procedure penale.

Me këtë rast, IKD vlerëson se kjo qasje e gjykatësve paraqet, para së gjithash, mohim të së drejtës së palëve në një vendim të arsyetuar gjyqësor.

Po ashtu, IKD e ka parasysh se përkundër ngjashmërive, secila vepër penale ka edhe specifikat e veta, të cilat specifika nuk lejojnë që dënimi në secilin rast të jetë unik. Por se, diferencën në mes rasteve e bënë pikërisht arsyetimi i aktgjykimit. Në fakt, përmes arsyetimit të një aktgjykimi, gjykata përpos palëve, u jep sqarime edhe qytetarëve mbi faktin se pse në një rast të caktuar është vendosur në një mënyrë të caktuar.

## Rekomandime:

1. Gjykatat me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, në përputhje me dispozitat e KPPRK-së dhe Udhëzuesit të Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore të arsyetojnë parimet e dënimit, qëllimin e dënimit si dhe secilën rrethanë lehtësuese dhe rënduese.

2. Me rastin e arsyetimit të vendimeve, Gjykatat të arsyetojnë secilin fakt dhe pretendim të ngritur gjatë procedurës penale, dhe jo që pjesa më e madhe e aktgjyqimit të jetë përshkrim i provave dhe dokumenteve të tjera që janë gjeneruar gjatë procedurës penale.


## 10. Gjetjet tjera të IKD-së

IKD përveç që ka bërë monitorimin sistematik të punës së prokurorive e gjykatave në trajtimin e lëndëve të ndryshme, rendësi të veçantë i ka kushtuar analizimit të aktgjyqimeve të veprave penale kundër integritetit seksual, ngarkesës së gjykatave dhe prokurorive më këtë kategori.

IKD në këtë raport ka analizuar 56 aktgjyqime, ku përfshihen 76 persona, ndaj të cilëve gjykatat kanë shqiptuar dënime të ndryshme, por nuk kanë munguar as rastet kur të njëjtit janë liruar nga akuza.

Në 56 aktgjyqimet e analizuar ku përfshihen 76 persona të akuzuar për vepra penale kundër integritetit seksual, IKD ka gjetur se ndaj 30 prej tyre vërehet se gjykatat themelore kanë shqiptuar dënim me burgim efektiv, ndaj 17 prej tyre dënim me kusht, ndaj 11 prej tyre dënim me gjobë, ndaj 15 personave janë shpallur aktgjyqime

liruese dhe ndaj tre (3) prej tyre aktgjyqime refuzuese.




Grafika 6: Dënimet e shqiptuara sipas 56 aktgjyqimeve të analizuar nga IKD

Sipas këtyre aktgjyqimeve përpos që viktimat kryesore të veprave penale kundër integritetit seksual janë gjinia femërore, nuk përjashtohen rastet kur edhe kjo gjini është e përfshirë në këto vepra penale si palë e akuzuar.

Mirëpo, sa i përket këtyre rasteve, IKD ka gjetur se 11 femrat e përfshira janë të akuzuara apo të dënuara vetëm për veprën penale “Mundësimi ose detyrimi në prostitucion” dhe për veprën penale “ofrimi i lokaleve për prostitucion”.

Në 56 aktgjyqimet e shkallës së parë të analizuar nga IKD, vërehet se dënimet me i lartë i shqiptuar në këto raste është dënimi me **7 vite burgim efektiv** për veprën penale “keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjet”.



**Grafika 7: Dënimet me burgim efektiv të shqiptuara nga GjTh-të sipas aktgjykimeve të analizuar nga IKD**

IKD përpos dënimeve me burgim efektiv, nga 76 persona, 17 prej tyre apo në 22% të rasteve kanë shqiptuar dënime me kusht.

Ndërsa, nga 76 të akuzuar, 11 prej tyre, apo 14% gjykatat kanë shqiptuar dënime me gjobë. Dënimi më i lartë me gjobë i shqiptuar për këto vepra penale, është dënimi me **3,600 euro gjobë** për veprën penale “*Keqpërdorim seksual duke përdorur pozitën, autoritetin apo profesionin*”, dënimi me **2,000 euro gjobë** për “*sulm seksual*” dhe dënimi me **1,800 euro** për veprën penale “*keqpërdorim i fëmijëve në pornografi, lidhur me veprën penale pornografia me fëmijë*”.

Ndërsa për veprat penale “**sulm seksual**” dhe “**ngacmim seksual**”, vërehet se gjykata kanë kursyer të shqiptojnë dënime më të larta pasi për këto vepra penale kanë shqiptuar vetëm dënime me gjobë dhe në asnjërin rast nuk kanë shqiptuar dënime tjera.

Pavarësisht, pse vepra penale “*Keqpërdorimi seksual duke përdorur pozitën, autoritetin apo profesionin*”, sipas nenit 239 par.1 pika 1.1 të KPRK , dënohet me 1 deri me 5 vite burgim, gjykatat në këtë rast i kishin shqiptuar 6 muaj burgim, por me pëlqimin e tij, ky dënim i ishte zëvendësuar me gjobë, edhe pse në këtë nen

nuk parashihet fare që kryesi të dënohet me gjobë.

IKD ka analizuar edhe rastet e 15 personave që janë liruar për disa vepra penale kundër integritetit seksual.

Nga 76 persona të akuzuar për vepra penale kundër integritetit seksual, IKD ka vërejtur se GjTh-të edhe pse dënime më të larta i kanë shqiptuar për veprën penale “*dhunimi*”, vërehet se për këtë veprë penale ka pasur raste kur të akuzuarit në mungesë të provave përfundimisht i kishte liruar nga akuza. Numrin më të madh të të akuzuarve që janë liruar nga akuza janë për këtë veprë penale, *me gjithsej 7 të liruar*.

Përpos aktgjykimeve liruese, nga 76 persona të akuzuar, gjykatat ndaj 3 prej tyre apo 4%, kanë shqiptuar aktgjykime refuzuese dhe atë për veprat penale “*sulm seksual*”, dhe “*dhunimi*”.



**Grafika 8: Numri i aktgjykimeve liruese dhe refuzuese sipas aktgjykimeve të analizuar nga IKD**

IKD në këtë raport ka analizuar edhe **25 aktgjykime të GjA-së** dhe vërejtur se vetëm në tri (3) raste ka ndryshuar aktgjykimet e shkallës së parë, ndërsa 22 aktgjykime të tjera i ka vërtetuar.

IKD ka vërejtur se në këto raste, GjA ka ulur dënimet që i ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë dhe në asnjërin rast nuk i

ka rritur dënimet e shqiptuara nga shkalla e parë.

IKD ka analizuar edhe 5 raste të veprave penale të integritetit seksual për të cilat ka vendosur edhe Gjykata Supreme. Në tri raste Supremja kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë i kishte cilësuar si të pabazuara, njërin rast e kishte kthyer në rivendosje dhe në njërin rast i kishte ndryshuar të dyja aktgjykimet atë të themelores dhe Apelit.

Sa i përket afateve ligjore, IKD gjen se në shumicën e rasteve këto afate nuk janë respektuar nga Gjykatat. Përkundër faktit se neni 242.4 i KPPRK përcakton se “*Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës*”, IKD gjen se në **48%** të rasteve gjykatat kanë respektuar këtë afat ligjor, ndërsa në **52%** të rasteve nuk e kanë respektuar.

Në këtë drejtim, IKD ka gjetur një rast kur **shqyrtimi fillestar ishte caktuar pas 1,744 ditësh apo pas 4 vite e 9 muaj** nga ngritja e aktakuzës, derisa ka edhe raste të tjera kur shqyrtimi fillestar është caktuar brenda një (1) dite.

Por, nëse e llogarisim mesataren e kohëzgjatjes nga ngritja e aktakuzës e deri në caktimin e shqyrtimit fillestar, sipas aktgjykimeve të analizuara nga IKD, del se mesatarja në këto raste është 243 ditë apo mbi 7 muaj.

Sa i përket kohëzgjatjes së procedurës penale në rastet e aktgjykimeve të formës së prerë, IKD ka gjetur raste kur kohëzgjatja e

procedurës penale nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit kanë kaluar 5439 ditë, apo 14 vite e 10 muaj<sup>17</sup>, derisa në anën tjetër IKD ka gjetur një rast kur aktgjykimi ishte shpallur vetëm një ditë pas ngritjes së aktakuzës.

Shprehur në mesataren e rasteve të cilat janë analizuar gjatë draftimit të këtij raporti, nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit në shkallë të parë, IKD gjen se mesatarja e përgjithshme e kohëzgjatjes nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit, **është 771 ditë, apo 2 vite e një (1) muaj.**

---

<sup>17</sup> *Shënim:* Rast i kthyer në rigjykim, ku i akuzuari përveç veprës penale dhunimi, ishte akuzuar edhe për vrasje.



## 11. Annex 1: Analizë e aktgjykimeve të veprave penale të integritetit seksual nga Gjykata Themelore gjatë viteve 2017-2019

IKD përpos ngarkesës më lëndë të sistemit të drejtësisë për lëndët nga kapitulli i integritetit seksual, ka analizuar edhe disa nga aktgjykimet e publikuara në ueb-faqen e KGJK-së për shtatë (7) GjTh-të dhe degët e tyre, analiza e të cilave raste është përshkruar në këtë annex.

### 1. 7 vite burgim për keqpërdorim seksual të të miturës

#### Gjykata Themelore në Ferizaj

Numri i lëndës: PKR.nr.25/19

Dt. e ngritjes së aktakuzës: 14.02.2019

**Vepra penale:** “*keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjet*” nga neni 235 par.1 nënpar. 1.1 të KPRK-ës

**Vendimi i gjykatës:** 7 vite burgim efektiv

Në këtë rast që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit kishin kaluar **një (1) muaj**.

GjTh në Ferizaj, me 14 mars 2019, të akuzuarin A.RR për keqpërdorim seksual të personave nën moshën 16 vjet, e kishte dënuar me **7 vite burgim efektiv**.

Sipas aktakuzës së ngritur me 14 shkurt 2019, i akuzuari A.Rr në dhjetor 2017, e kishte keqpërdorur seksualisht një të mitur 15 vjeçare të cilën e kishte lënë edhe shtatzënë dhe me 22 gusht 2018, e dëmtuara kishte lindur foshnjën mashkull, ku nga raporti i ekspertimit kishte konstatuar se i akuzuari ishte babai biologjik.

I akuzuari në seancën fillestare të mbajtur me 13 mars 2019, e kishte pranuar fajësinë. E dëmtuara F.I, për kërkesën pasurore-

juridike ishte udhëzuar në kontest civil.

### 1. 5 vite burgim efektiv për të akuzuarin për dhunim

#### Gjykata Themelore në Ferizaj

Numri i lëndës: . PKR.nr.33/19

Dt. e ngritjes së aktakuzës: 01.03.2019

**Vepra penale:** “*dhunimi*”, nga neni 230 par. 4 nën par.4.2 lidhur me par 1 të KPRK-së

**Vendimi i gjykatës:** 5 vite burgim efektiv

Në këtë rast që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit kishin kaluar **28 ditë**.

GjTh në Ferizaj, me 29 mars 2019, të akuzuarin për veprën penale “*dhunimi*”, A.H, e kishte dënuar me **5 vite burgim** pasi i njëjti në seancën fillestare të mbajtur me 29 mars 2019, edhe e kishte pranuar fajësinë për këtë vepër penale.

Sipas aktakuzës së ngritur me 1 mars 2019, i akuzuari e kishte keqpërdorur seksualisht një të mitur në dhjetor të vitit 2018. Në arsyetimin e aktgjykimit thuhet se gjykata me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit kishte marrë për bazë rrethanat veçanërisht lehtësuese si pranimi i pafajësisë që në shqyrtim fillestar, pendimin e tij të singertë dhe real për veprën e kryer, baba i një fëmiu, i gjendjes së varfër ekonomike, i moshës së re. Ndërsa si rrethanë renduese gjykata kishte marrë për bazë të kaluarën kriminale të të akuzuarit, shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe rrezikshmërisë konkrete të veprës penale.

## 2. 5 vite burg për të akuzuarin që kishte abuzuar me një 14 vjeçare

### Gjykata Themelore në Prizren

Numri i lëndës: PKR.nr.95/2017

Dt. e ngritjes së aktakuzës: 27.09.2017

**Vepra penale:** “*keqpërdorim seksual i personave nën moshën 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjet*”, nga neni 235 paragraf 2 nën paragraf 2.3 të KPK-së

**Vendimi i gjykatës:** 5 vite burgim

Në këtë rast që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit kishin kaluar **vetëm një (1) javë.**

GjTh në Prizren, Departamenti për të Mitur, me 3 tetor 2017, të akuzuarin për veprën penale “*keqpërdorim seksual i personave nën moshën 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjet*”, G.S e kishte dënuar me **5 vite burgim efektiv**, pasi i njëjti në shqyrtim fillestar të mbajtur me 3 tetor 2017, e kishte pranuar fajësinë.

Sipas aktakuzës së ngritur me 27 shtator 2017, i akuzuari dyshohej se e kishte prekur të dëmtuarën e cila kishte qenë nën moshën 14 vjet. Në arsyetimin e këtij aktgjykimi thuhet se gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata kishte marrë parasysh rrethanat rënduese si: kjo veprë penale paraqet rrezikshmëri të lartë shoqërore, cenohet pjesa më e ndjeshme e shoqërisë, simptomat postraumatike emocionale dhe të sjellës së shëndetit mendor të viktimës. Po ashtu kjo gjykatë si rrethanë rënduese kishte marrë për bazë edhe shkallën e lartë të dashjes së të akuzuarit, si dhe moshën e viktimës, ndërsa si rrethanë lehtësuese ishte vlerësuar pranimi i fajësisë keqardhja e shfaqur e të akuzuarit, bashkëpunimi i tij me gjykatës, sjellja e tij pas ndodhjes së veprës.

## 3. Pranoi fajësinë për dhunim, dënohet me 5 vite burgim

### Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.95/2017

Dt. e ngritjes së aktakuzës: 27.09.2017

**Vepra penale:** “*Dhunimi*”, nga neni 193 par.3 nënpar. 5 lidhur me nenin 23 të KPK-së dhe *Grabitje*, nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së

**Vendimi i gjykatës:** 5 vite burgim efektiv

Në këtë rast që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit kishin kaluar **një (1) vit e dy (2) muaj.**

GjTh në Prishtinë, me 5 shtator 2017, të akuzuarin për veprën penale “*Dhunimi*”, dhe “*grabitja*”, e kishte dënuar me **5 vite burgim efektiv**, pasi i njëjti në fund të shqyrtimit gjyqësor e kishte pranuar fajësinë.

Sipas aktakuzës së ngritur me 17 qershor 2016, i akuzuari F.S, së bashku me një person të panjohur, me 20 gusht 2007, duke kanosur dhe kërcënuar me armë të dëmtuarin e kishin futur në bagazh të automjetit, ndërsa të dëmtuarën e kishin detyruar të kryejë marrëdhënie seksuale me tre të akuzuar.

Përveç veprës penale të dhunimit, i akuzuari është dënuar edhe për veprën penale “**grabitje**”, me **tri vite burgim, ndërsa gjykata ndaj tij kishte shqiptuar dënim unik në kohëzgjatje prej 7 vitesh e 6 muaj.**

I akuzuari në këtë rast në seancën fillestare nuk e kishte pranuar fajësinë për asnjërën pikë të aktakuzës, por në përfundim të shqyrtimit gjyqësor kishte vendosur të pranojë fajësinë për të dy veprat penale. Në arsyetimin e aktgjykimit thuhet se gjykata

me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit si rrethanë lehtësuese kishte marrë për bazë sjelljen korrekte të të akuzuarit në gjykatë, pranimin e fajësisë, pendimin, ishte familjar, baba i dy fëmijë të mitur, i pa papunë i gjendjes së dobët ekonomike, dhe se për herë të parë kishte rënë ndesh me ligjin. Ndërsa si rrethana renduese sipas gjykatës, ishte vlerësuar pesha e rëndë e veprave penale si dhe mënyra e kryerjes.

#### 4. Dënohet me 3 vite burgim për dhunim

##### Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.72/18

Dt. e ngritjes së aktakuzës: 21.03.2019

Vepra penale: “*dhunimi*”, nga neni 230 par.4 pika 4.1,4.2, 4.4 lidhur me par.1 të KPRK

Vendimi i gjykatës: 3 vite burgim efektiv

Në këtë rast që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit kishin kaluar **9 muaj**.

GjTh në Prishtinë, me 24 dhjetor 2018, të akuzuarin për veprën penale “*dhunimi*”, M.P e kishte dënuar me **3 vite burgim**, ku të njëjtën ditë ia kishte ndërprerë edhe masën e paraburgimit.

Sipas aktakuzës së ngritur me 21 mars 2018, i akuzuari M.P në nëntor 2017, e kishte detyruar të dëmtuarën që të kryej akt seksual pa pëlqimin e saj, duke e sulmuar fizikisht dhe me një kaçavidë dhe skalper. Me 25 prill 2018, ishte mbajtur seanca fillestare në këtë rast në të cilën i akuzuari nuk e kishte pranuar fajësinë, por fajësinë e kishte pranuar në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me 20 dhjetor 2018.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi thuhet se gjykata me rastin e përcaktimit të vendimit

mbi dënimin, kishte pasur parasysh rrethanat lehtësuese: pranimin e fajësisë, shprehjen e keqardhjes dhe kërkim faljes ndaj të dëmtuarës, pendimin e shprehur për veprën e kryer si dhe premtimin e dhënë publikisht se në të ardhmen asnjëherë nuk do t’a trazojë të dëmtuarën me të cilën kishin qenë në lidhje dashurie një kohë bukur të gjatë, faktin se i akuzuari në bazën e shënimeve në këtë gjykatë, se nuk ka dëshmi se ndaj tij ishte duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale. Ndërsa si rrethanë renduese në arsyetim të gjykatës thuhet se nuk ishte gjetur, dhe se gjykata i kishte shqiptuar dënim të zbutur me bindje se ky dënim i përgjigjet peshës së veprës penale.

#### 5. 3 vite burg për keqpërdorim seksual të të miturës 11 vjeçare

##### Gjykata Themelore në Ferizaj

Numri i lëndës: PKR.nr.227/18

Dt. e ngritjes së aktakuzës: 10.12.2018

Vepra penale: “*keqpërdorim seksual i personit nën moshën 16 vjet*”;

Vendimi i gjykatës: 3 vite burgim efektiv

Në këtë rast që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit kishin kaluar **17 ditë**.

GjTh në Ferizaj, të akuzuarin për veprën penale “*keqpërdorim seksual i personit nën moshën 16 vjet*”, I.S, me 26 dhjetor 2018 e kishte dënuar me **3 vite burgim**.

Sipas aktakuzës së ngritur me 10 dhjetor 2018, i akuzuari I.S e kishte keqpërdorur seksualisht një të mitur të moshës 11 vjeçare. Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me 26 dhjetor 2018 i akuzuari e kishte pranuar fajësinë. E dëmtuara përmes përfaqësuesit ligjor kishte hequr dorë nga kërkesa pasurore-juridike.

## 6. Dy vite për të akuzuarin për dhunim

### Gjykata Themelore në Ferizaj

**Numri i lëndës:** PKR.nr.31/2017

**Dt. e ngritjes së aktakuzës:** 27.02.2017

**Vepra penale:** “*dhunimi*” nga neni 230 par.1 të KPRK-së; “*mashtrimi*” nga neni 335 par.1 të KPRK-së

**Vendimi i gjykatës:** 2 vite

Në këtë rast që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit kishin kaluar **4 muaj**.

GjTh në Ferizaj, me 4 korrik 2017, të akuzuarin për veprën penale “*dhunimi*”, e kishte dënuar me **2 vite burgim**, ndërsa për veprën penale “*mashtrimi*”, e kishte dënuar me 1 vit burgim dhe 500 euro gjobë.

Ndaj tij kjo gjykatë kishte shqiptuar dënim unik në kohëzgjatje prej dy vite e gjashtë muaj dhe gjobë në shumë prej 500 euro. Sipas aktakuzës së ngritur me 27 shkurt 2017, i akuzuari R.A, në dhjetor të vitit 2016, me anë të mashtimit e kishte detyruar të dëmtuarën Q.G që të kryejë marrëdhënies seksuale pa pëlqimin e saj. Në aktakuzë thuhet se kishin komunikuar përmes “facebook”, ku i njëjti i kishte premtuar se do t’ia rregulloj dokumentacionin për të shkuar në Angli.

**I akuzuari është obliguar që të dëmtuarës në emër të kërkesës pasurore-juridike t’ia kompensojë dëmin e shkaktuar në vlerë prej 2,500 euro.**

I akuzuari në këtë rast e kishte pranuar fajësinë në shqyrtim gjyqësor. Sipas arsytimit të këtij aktgjykimi, gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit pati parasysh rrethanat lehtësuese si: pranimin e fajësisë, kishte shprehur keqardhje dhe pendim për

veprat e kryera, nuk kishte qenë më parë i dënuar, i gjendjes së dobët ekonomike, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata kishte vlerësuar se ai me paramendim të gjatë duke shfrytëzuar rrjetin social “facebook”, rreth 6-7 muaj kishte biseduar me viktimën dhe përmes mashtimit të saj duke e shfrytëzuar gjendjen e rëndë ekonomike të viktimës, moshën e saj të re 22 vjeçare, shkollimin e saj, e kishte kryer veprën penale.

## 7. Dy vite burgim për të akuzuarin që e kishte abuzuar seksualisht një person me çrregullime mendore

### Gjykata Themelore në Pejë

**Numri i lëndës:** P.nr.129/16

**Dt. e ngritjes së aktakuzës:** 17.06.2016

**Vepra penale:** “*keqpërdorim seksual i personave me çrregullime ose paaftësi mendore apo emocionale*”, nga neni 234 par.1 të KPRK-së;

**Vendimi i gjykatës:** 2 vite

Në këtë rast që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit kishin kaluar **1 vit e 7 muaj**.

GjTh në Pejë, me 6 shkurt 2018, të akuzuarin për veprën penale “*keqpërdorim seksual i personave me çrregullime ose paaftësi mendore apo emocionale*”, e kishte dënuar me **dy vite burgim**.

Sipas aktakuzës së ngritur me 17 qershor 2016, i akuzuari V.M, e kishte detyruar personin me personin me çrregullime apo paaftësi mendore apo emocionale, për të kryer akt seksual, ku pas një kontrolli mjekësor, viktimja kishte rezultuar shtatzënë në muajin e 7 (shtatë). Në arsytimin e aktgjykimit thuhet se më rastin e shqiptimit të dënimit gjykata kishte

vlerësuar rrethanat lehtësuese se i akuzuari kishte pasur sjellje korrekte para gjykatës, ishte i gjendjes së dobët ekonomike, dhe se nuk kishte qenë i dënuar më parë, ndërsa si rrethanë renduese gjykata kishte marrë për bazë faktin se si pasojë e kësaj vepre e dëmtuara kishte lindur një fëmijë dhe se duke pasur parasysh gjendjen e saj mendore e njëjta e kishte të vështirë të kujdeset për të.

#### **8. Dy vite burgim dhe 5 mijë euro gjobë për të akuzuarin që kishte ndihmuar persona për qëllime prostitucioni**

**Gjykata Themelore në Prizren**  
**Numri i lëndës:** PKR.nr.241/2015  
**Dt. e ngritjes së aktakuzës:** 17.06.2016  
**Vepra penale:** “*mundësimi ose detyrimi në prostitucion*”, nga neni 241 paragraf 1 të KPK-së,  
**Vendimi i gjykatës:** 2 vite burgim efektiv dhe 5.000 euro gjobë

Në këtë rast që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit kishin kaluar **një (1) vit e pesë (5) muaj**.

GjTh në Prizren, Departamenti për të Mitur, me 29 maj 2017, të akuzuarin për veprat penale “*mundësimi ose detyrimi në prostitucion*”, M.K e kishte dënuar me dy vite burgim dhe 5,000 euro gjobë, pasi i njëjti sipas aktakuzës së ngritur me 22 dhjetor 2015, kishte ndihmuar dhe kontrolluar persona për qëllime të prostitucionit, duke iu gjetur tri të dëmtuarave klientë për shërbime seksuale.

Ndërkaq, të akuzuarit për veprën penale “*shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit*”, nga neni 231 paragraf 1 të KPK-së, ishin liruar nga akuza. Fillimisht i akuzuari M.K ngarkohej me

veprën penale “*trafikim me njerëz*”, ndërsa në fjalën përfundimtare prokurori kishte bërë ricilësimin e veprës penale në “*mundësimi ose detyrimi në prostitucion*”. Në arsyetim të aktgjykimi thuhet se me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, gjykata kishte vlerësuar rrethanat lehtësuese se i akuzuari ishte njeri familjar dhe mbajtës i familjes, ndërsa nga rrethanat renduese ishin vlerësuar: mosha e viktimave dhe pozita e tyre e ndjeshme, keqpërdorimi i pozitës së tij dhe shkelja e besimit, ngase e dëmtuara dhe vajza e të akuzuarit ishin shoqe dhe njiheshin familjarisht, dhe ishte vlerësuar motivi i të akuzuarit për motive të natyrës fitimprurëse, si dhe faktin se i akuzuari ishte përsëritës i këtyre veprave penale të kësaj natyre.

#### **9. Dy vite burgim për marrëdhënie seksuale me dhunë**

**Gjykata Themelore në Prishtinë**  
**Numri i lëndës:** PKR.nr.352/18  
**Dt. e ngritjes së aktakuzës:** 13.07.2004  
**Vepra penale:** “*Marrëdhënie seksuale me dhunë*”, nga neni 74 alineja 2 pika 3 të LPK-së, etj  
**Vendimi i gjykatës:** 2 vite burgim efektiv

Në këtë rast që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit kishin kaluar **14 vite e 10 muaj**.

GjTh në Prishtinë, me 3 qershor 2019, të akuzuarin për veprat penale “*Marrëdhënie seksuale me dhunë*”, A.Sh e kishte dënuar me dy vite burgim, ndërsa për veprën penale “*vrasja*”, nga neni 30 alineja 2 të LPK-së, e kishte dënuar me 15 vite.

Po ashtu dënimi i shqiptuar prej 18 vitesh nga gjykata e Qarkut dhe i ndryshuar nga

Supremja, si dhe dënimi për këto dy vepra penale, gjykata i kishte shqiptuar dënim unik në 20 viteve. Ndërsa i akuzuari i dytë në këtë rast I.R, për veprën penale “*marrëdhënie seksuale me dhunë*”, është dënuar me dy vite burgim me kusht, dënim i cili nuk do të ekzekutohet nëse i njëjti brenda periudhës prej 4 vitesh nuk kryen veprën tjetër penale.

Fillimisht për këtë rast, ish-gjykata e Qarkut në maj të viti 2007 dy të akuzuarit i kishte shpallur fajtor për tri vrasje të rënda në bashkëveprim dhe veprën penale “*marrëdhënie seksuale me dhunë*”. Mirëpo Supremja në janar 2008 e kishte anuluar këtë aktgjykim dhe çështjen e kishte kthyer në rigjykim.

Pas rigjykimit, i akuzuari I,R ishte shpallur fajtor për tri vepra penale të vrasjes së rëndë dhe ishte gjykuar me 12 vite burgim, ndërsa i akuzuari A.Xh ishte gjetur fajtor për ndihmë në vrasje të rëndë dhe ishte gjykuar me 4 vite e 6 muaj.

Mirëpo Supremja në dhjetor 2008 e kishte ndryshuar aktgjykimin e ish-gjykatës së Qarkut, dhe të akuzuarin I.R për vrasje të rëndë i kishte shqiptuar dënim prej 15 vitesh, për një rënë veprën penale të vrasjes së rëndë e kishte liruar nga akuza, ndërsa për veprën tjetër penale të vrasjes së rëndë, e kishte bërë ndryshimin e cilësimit juridik ashtu që e ka ricilësuar në veprën penale Privim pa të drejtë nga liria i parashikuar nga neni 63 par.1 i LPS-së, ndërsa që lidhur me veprën penale “*Marrëdhënie seksuale me dhunë*”, e cila sipas aktgjykimit të gjykatës së Qarkut ishte konsumuar në veprën penale të Vrasjes, e kishte kthyer çështjen në rigjykim në gjykatës e shkallës së parë.

Ndërsa të akuzuarit A.Xh i kishte shqiptuar dënim prej 7 vitesh. Pastaj Gjykata e Apelit në nëntor 2018 e kishte anuluar aktgjykimin e shkallës së parë të qershorit 2018 dhe rastin e kishte kthyer në rigjykim.

Sipas aktakuzës së ngritur me 13 korrik 2004, dy të akuzuarit në nëntor të vitit 1999, kishin shkuar tek shtëpia e të ndjerës e kishin futur në makinë, e kishin dërguar në një fshat dhe pasi kishin kryer marrëdhënie seksuale me pretendimin se e njëjta kishte bashkëpunuar me policinë serbe, i akuzuari A.Xh kishte shtënë në drejtim të saj.

#### **10. Një vit e gjysmë për keqpërdorim seksual të të miturës**

##### **Gjykata Themelore në Gjiilan**

**Numri i lëndës:** PKR.nr.252/2018

**Dt. e ngritjes së aktakuzës:** 23.02.2018

**Vepra penale:** “*keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjet*”, nga neni 235 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-së

**Vendimi i gjykatës:** 1 vit e 6 muaj burgim

Në këtë rast që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit kishin kaluar **1 vit e 2 muaj**.

GjTh në Gjiilan, Departamenti për të Mitur, me 17 maj 2019, të akuzuarin për veprën penale “*keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjet*”, Sh.B e kishte dënuar me 1 vit e gjashtë muaj burgim, pasi i njëjti sipas aktakuzës së ngritur me 23 shkurt 2018, se kishte keqpërdorur seksualisht të dëmtuarën nën moshën 16 vjeç. Në aktakuzë thuhet se i akuzuari deri në vjeshtë 2016, pa i mbushur e dëmtuara 16 vjeç, e kishte prekur, puthur dhe përçafur për qëllime seksuale.

## 11. Dënime me burg dhe me gjobë për të akuzuarit për mundësim në prostitucion

### Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: P.nr.4857/19

Dt. e ngritjes së aktakuzës: 22.11.2019

**Vepra penale:** “Ofrimi i lokaleve për prostitucion”, nga neni 235 par.2 të KPRK-së; “Mundësimi ose detyrimi në prostitucion”, nga neni 234 par. 2 të KPRK-së

**Vendimi i gjykatës:** 1 vit e 6 muaj dhe 2,500 euro; 8 muaj dhe 1,000 euro

Në këtë rast që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit kishin kaluar **35 ditë**.

GjTh në Prishtinë, DP, të akuzuarin P.S, me 26 dhjetor 2019, për veprën penale “Ofrimi i Lokaleve për prostitucion”, e kishte dënuar me 1 vit burgim dhe 1,300 euro gjobë, ndërsa për veprën penale “Mundësimi ose detyrimi në prostitucion” 10 muaj dhe 1,200 euro gjobë. Ndaj tij kjo gjykatë kishte shqiptuar dënim unik prej 1 viti e 6 muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 2,500 euro. Dy të akuzuarat, për veprat penale “mundësimi ose detyrimi në prostitucion”, i kishte dënuar me nga 8 muaj burgim dhe nga 1,000 euro gjobë.

Sipas aktakuzës së ngritur me 22 nëntor 2019, i akuzuari P.S kishte ofruar lokalin e tij për të zhvilluar prostitucion nga masazheret punonjëse në këtë lokal, si dhe kishte rekrutuar, ndihmuar, kontrolluar personat e tjerë me qëllim të prostitucionit duke punësuar pesë masazhere të cilat edhe kishin kryer prostitucionin. Ndërsa të akuzuarat A.C dhe Xh.A, kishin organizuar, ndihmuar personat e tjerë me qëllim të prostitucionit, duke caktuar orare

përmes rrjetit social “snapchat”, sipas dëshirave të klientëve. Tre të akuzuarit e kishin pranuar fajësinë për veprat penale që i viheshin në barrë.

## 12. Një vit e gjysmë për të akuzuarin për dhunim në ndihmë

### Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.60/17

Dt. e ngritjes së aktakuzës: 31.12.2012

**Vepra penale:** “Dhunimi në ndihmë”, nga neni 230 par.1 lidhur me nenin 33 të KPK-së.

**Vendimi i gjykatës:** 1 vit e 6 muaj

Në këtë rast që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit kishin kaluar **5 vite**.

GjTh në Prishtinë, të akuzuarin D.U, me 1 qershor 2018, e kishte dënuar me 1 vit e 6 muaj, për veprën penale “Dhunimi në ndihmë”, nga neni 230 par.1 lidhur me nenin 33 të KPK-së.

Sipas aktakuzës së ngritur me 31 dhjetor 2012, i akuzuari D.U me 8 tetor 2013, së bashku me të dënuarit A.Sh, e kishin takuar të dëmtuarën L.Ll dhe i kishin premtuar ta dërgojnë në vendin ku e dëmtuara kishte kërkuar, por gjatë rrugës, i akuzuari e kishte kërcënuar të dëmtuarën me qëllim që e njëjta të mos kundërshtoj dhe së bashku me të dënuarin A.Sh e kishin dërguar në një kafiteri, e kishte goditur me shkelma dhe duke e kërcënuar me thikë, i kishte bërë roje të akuzuarit A.Sh për të kryer veprën e dhunimit.

Fillimisht, GjTh në Prishtinë me 8 prill 2013, e kishte shpallur aktgjykimin në këtë rast, por Gjykata e Apelit, me 27 janar 2017, kishte miratuar ankesën e mbrojtjes dhe rastin e kishte kthyer në rigjykim vetëm

sa i përket veprës penale “Dhunim në ndihmë”, nga neni 230 par.1 lidhur me nenin 33 të KPK-se, ndërsa e kishte vërtetuar aktgjykimin sa i përket veprës penale Rrëmbimi në bashkëkryerje nga neni 159 par.2 lidhur me par.1 dhe 23 të KPK-së.

### 13. Një vit burgim për sulm seksual

#### Gjykata Themelore në Ferizaj

**Numri i lëndës:** P.nr.2163/17

**Dt. e ngritjes së aktakuzës:** 30.08.2017

**Vepra penale:** “sulm seksual” nga neni 232 par.3 nënpar 3.2 lidhur me par.1 të KPRK-së

**Vendimi i gjykatës:** 1 vit

Në këtë rast që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit kishin kaluar **mbi 1 muaj.**

GjTh në Ferizaj, të akuzuarin për “sulm seksual”, me 12 shtator 2017 e kishte dënuar me 1 vit burgim efektiv.

Sipas aktakuzës së ngritur me 30 gusht 2017, e kishte sulmuar seksualisht të dëmtuarën duke e ndjekur nga mbrapa dhe duke përdorur forcën për qëllime seksuale e kishte kapur nga fyti dhe më pas për gjoksi dhe vithe.

I akuzuari e kishte pranuar fajësinë në fazën fillestare.

### 14. Një vit burg për të akuzuarin që keqpërdori seksualisht një person me çrregullime mendore

#### Gjykata Themelore në Gjiilan

**Numri i lëndës:** PKR.nr.146/2015

**Dt. e ngritjes së aktakuzës:** 17.10.2014

**Vepra penale:** “keqpërdorimi seksual i personave me çrregullime mendore apo emocionale”, nga neni 234 par.1. të KPRK

**Vendimi i gjykatës:** 1 vit

Në këtë rast që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit kishin kaluar afër **3 vite.**

GjTh në Gjiilan, DKR, me 23 mars 2017 të akuzuarin A.S e kishte dënuar me 1 vit burgim efektiv për veprën penale “keqpërdorimi seksual i personave me çrregullime mendore apo emocionale”.

Sipas aktakuzës së ngritur me 17 tetor 2014, i akuzuari A.S në tetor 2014, kishte kryer marrëdhënies seksuale me viktimën me çrregullime mendore, duke e keqpërdorur pozitën e ndjeshme të saj.

I akuzuari nuk e kishte pranuar fajësinë në asnjë fazë të procedurës.

### 15. 1 vit burgim për të akuzuarin që tentoi të kryejë akt seksual me një fëmijë me ngecje mendore

#### Gjykata Themelore në Prizren

**Numri i lëndës:** P.nr.148/2016

**Dt. e ngritjes së aktakuzës:** 16.09.2016

**Vepra penale:** “keqpërdorimi seksual i personave me çrregullime mendore apo emocionale”, nga neni 234 paragraf 4 nënparagrafi 4.7 lidhur me paragraf 1 dhe nenin 28 të KPK-së.

**Vendimi i gjykatës:** 1 vit



Në këtë rast që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit kishin kaluar **mbi 9 muaj**.

GjTh në Prizren, DM, me 7 korrik 2017, e kishte dënuar me 1 vit burgim efektiv të akuzuarin N.Th i cili dyshohej për veprën penale “*keqpërdorim seksual i personave me çrregullime ose paaftësi mendore apo emocionale*”, nga neni 234 paragraf 4 nënparagrafi 4.7 lidhur me paragraf 1 dhe nenin 28 të KPK-së.

Sipas aktakuzës së ngritur me 16 shtator 2016, tenton të kryejë akt seksual me një fëmijë me ngecje mendore të mesme, mirëpo zihet në flagrancë nga ana e policisë dhe pengohet në përfundimin e qëllimit të synuar-kryerjen e aktit seksual.

I akuzuari nuk e kishte pranuar fajësinë.

#### **16. Tetë muaj burg dhe 1 mijë euro gjobë për mundësim në prostitucion**

**Gjykata Themelore në Prishtinë**

**Numri i lëndës:** P.nr.4857/19

**Dt. e ngritjes së aktakuzës:** 22.11.2019

**Vepra penale:** “*Mundësimi ose detyrimi në prostitucion*”, nga neni 234 par. 2 të KPRK-së

**Vendimi i gjykatës:** 8 muaj burgim, 1,000 euro gjobë

Në këtë rast që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit kishin kaluar **35 ditë**.

GjTh në Prishtinë, me 26 dhjetor 2019, dy të akuzuarat A.C dhe Xh.A, për veprën penale “*Mundësimi ose detyrimi në prostitucion*”, nga neni 234 par. 2 të KPRK-së, i kishte dënuar me nga 8 muaj burgim dhe nga 1,000 euro gjobë.

Sipas aktakuzës së ngritur me 22 nëntor 2019, të akuzuarat kishin organizuar, ndihmuar personat e tjerë me qëllim të prostitucionit, duke caktuar orare përmes rrjetit social “snapchat”, sipas dëshirave të klientëve. Tre të akuzuarit e kishin pranuar fajësinë për veprat penale që i viheshin në barrë.

s

#### **17. Shtatë muaj burg për të akuzuarën që i siguroi vajzës së saj klient në këmbim të parave**

**Gjykata Themelore në Prizren**

**Numri i lëndës:** P.nr.1515/16

**Dt. e ngritjes së aktakuzës:** 12.07.2016

**Vepra penale:** “*Mundësimi ose detyrimi në prostitucion*”, nga neni 234 par. 1 të KPRK-së,

**Vendimi i gjykatës:** 7 muaj

Në këtë rast që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit kishin kaluar **mbi 8 muaj**.

GjTh në Prizren të akuzuarën për *mundësim ose detyrim në prostitucion*, me 5 prill 2017 e kishte dënuar **me shtatë (7) muaj burgim efektiv**.

Sipas aktakuzës së ngritur me 12 korrik 2016, e njëjta vajzës së saj B.K i kishte siguruar klientë të ndryshëm për të kryer marrëdhënie seksuale në këmbim të parave dhe atë në shumën prej 40 euro, duke i kontaktuar klientët përmes telefonit e duke aranzhuar takime në banesën e saj.

E akuzuara nuk e kishte pranuar fajësinë.

## 18. Burgim dhe gjobë për mundësim në prostitucion

### Gjykata Themelore në Ferizaj

Numri i lëndës: P.nr.3036/17

Dt. e ngritjes së aktakuzës: 05.12.2017

**Vepra penale:** “mundësimi ose detyrim në prostitucion”, nga neni 241 par.1 të KPRK-së”;

**Vendimi i gjykatës:** 7 muaj, 500 euro

Në këtë rast që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit kishin kaluar **1 vit e 7 muaj**.

GjTh në Ferizaj, DP, të akuzuarin për veprën penale “mundësimi ose detyrim në prostitucion”, me 22 korrik 2019, e kishte dënuar me **7 muaj burgim efektiv dhe 500 euro gjobë**.

Sipas aktakuzës së ngritur me 5 dhjetor 2017, i akuzuari i kishte siguruar klientë të dëmtuarës M.N që të kryejë marrëdhënie seksuale në këmbim të parave. I akuzuari e kishte pranuar fajësinë.

E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

## 19. Gjashtë muaj burgim për keqpërdorim seksual të asistentes

### Gjykata Themelore në Ferizaj

Numri i lëndës: P.nr.371/16

Dt. e ngritjes së aktakuzës: 23.03.2016

**Vepra penale:** “keqpërdorimi seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin apo profesionin”, nga neni 239 par.1 nën par.1.1 të KPRK-së

**Vendimi i gjykatës:** 6 muaj (zëvendësim në 2,000 euro)

Në këtë rast që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit kishin kaluar **mbi 3 vite**.

GjTh në Ferizaj, DP, me 1 tetor 2019, të akuzuarin B.M, për veprën penale “keqpërdorimi seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin apo profesionin”, nga neni 239 par.1 nën par.1.1 të KPRK-së, e kishte dënuar me **6 muaj burgim efektiv**, mirëpo me pëlqimin e tij ky dënim mund ti zëvendësohet në gjobë në shumë prej 2,000 euro.

Sipas aktakuzës së ngritur me 23 mars 2016, pasi të dëmtuarën e kishte punësuar në firmën e tij në pozitën e asistentes, i njëjti e kishte keqpërdorur seksualisht të dëmtuarën pa dëshirën e saj, pasi e njëjta nën ndikimin e alkoolit nuk kishte ditur të kontrolloj veprimet e veta. I akuzuari kishte qenë i ngarkuar edhe me veprën penale “shantazhi”, mirëpo për këtë vepër penale ishte liruar nga akuza.

I akuzuari në asnjë fazë të procedurës nuk e kishte pranuar fajësinë.

## 20. Burg dhe gjobë për mundësim në prostitucion

### Gjykata Themelore në Ferizaj

Numri i lëndës: P.nr.1229/17

Dt. e ngritjes së aktakuzës: 18.05.2017

**Vepra penale:** “mundësimi apo detyrimi në prostitucion”, “ofrimi i lokaleve për prostitucion”;

**Vendimi i gjykatës:** 6 muaj burgim dhe 2,000 euro gjobë; 3 muaj burgim dhe 2,000 euro gjobë; 3 muaj me kusht brenda një viti dhe 2,000 euro gjobë; 3 muaj me kusht brenda një viti dhe 300 euro gjobë;

Në këtë rast që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit kishin kaluar **14 ditë**.

GjTh në Ferizaj, DP, me 31 maj 2017, të akuzuarin e parë për veprën penale “mundësimi apo detyrimi në prostitucion”, e kishte dënuar me gjashtë muaj burgim efektiv dhe 2.000 gjobe, të akuzuarin e dytë për veprën penale “ofrimi i lokaleve për prostitucion”, me 3 muaj burgim efektiv dhe 2,000 gjobë, të akuzuarin e tretë për “mundësimi apo detyrimi në prostitucion”, dënohet me 3 muaj burgim me kusht, i cili nuk do të ekzekutohet nëse i njëjti nuk kryen ndonjë vepër penale brenda një viti, si dhe 500 euro gjobë.

Ndërsa e akuzuara e katërt për veprën penale “mundësimi apo detyrimi në prostitucion”, është dënuar me 3 muaj burgim me kusht i cili nuk do të ekzekutohet nëse i njëjti brenda periudhës prej 1 viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, si dhe 300 euro gjobë.

Ndryshe në këtë rast katër të akuzuarit kishin lidhur marrëveshje me prokurorinë për pranim të fajësisë.

## 21. Burg dhe gjobë për detyrim në prostitucion

### Gjykata Themelore në Prizren

Numri i lëndës: P.nr.720/17

Dt. e ngritjes së aktakuzës: 04.04.2017

**Vepra penale:** “mundësimi apo detyrimi në prostitucion”,

**Vendimi i gjykatës:** 6 muaj burgim dhe 2,000 euro gjobë;

Në këtë rast që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit kishin kaluar **16 ditë**.

GjTh në Prizren, me 22 prill 2017, dy të akuzuarit për veprën penale “mundësimi ose detyrimi në prostitucion”, i kishte dënuar me nga 6 muaj burgim efektiv dhe 2,000 euro gjobë.

Sipas aktakuzës së ngritur me 4 prill 2017, dy të akuzuarit e kishin detyruar një person që të merret me prostitucion, duke ofruar shërbime në masazhe dhe shërbime seksuale me femra me një çmim prej 250 euro për një femër.

Dy të akuzuarit dhe prokuroria kishin lidhur marrëveshje për pranim të fajësisë.

## 22. Dënime për të akuzuarat që kishin shfrytëzuar klientë për prostitucion

### Gjykata Themelore në Ferizaj

Numri i lëndës: P.nr.296/2019

Dt. e ngritjes së aktakuzës: 04.03.2019

**Vepra penale:** “ofrimi i lokaleve për prostitucion”, nga neni 242 lidhur me nenin 31 të KPRK-së “mundësimi apo detyrimi në prostitucion”, nga neni 241 par.1 lidhur me nenin 31, të KPRK-së;

**Vendimi i gjykatës:** 6 muaj burgim dhe 600 euro gjobë; 4 muaj burgim dhe 200 euro gjobë; 4 muaj burgim me kusht brenda 2 viteve dhe 300 euro gjobë;

Në këtë rast që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit kishin kaluar **2 muaj**.

GjTh në Ferizaj, me 15 maj 2019, të akuzuarën për veprën penale “ofrimi i lokaleve për prostitucion”, nga neni 242 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, e kishte dënuar me 3 muaj burgim dhe 300 euro gjobë, ndërsa për veprën penale “mundësimi ose detyrimi në prostitucion”, nga neni 241 par.1 lidhur me nenin 31 e kishte dënuar me 4 muaj burgim dhe 300 euro gjobë, ndërsa gjykata i kishte shqiptuar dënim në kohëzgjatje prej 6 muaj dhe 600 euro gjobë.

Të akuzuarën e dytë, për veprën penale “mundësim ose detyrimi në prostitucion”, gjykata i kishte shqiptuar dënim prej 4 muaj dhe 200 euro gjobë, ndërsa të akuzuarën e tretë, për veprën penale “ofrimi i lokaleve për prostitucion”, e kishte dënuar me 4 muaj me kusht, brenda 2 viteve, si dhe 300 euro gjobë.

Aktakuza ndaj tyre ishte ngritur me 4 mars 2019, pasi pretendohet se në shkurt 2019, e

akuzuara E.B në cilësinë e pronares së një moteli, ndërsa e akuzuara B.B në cilësinë e mbikëqyrëses së lokalit, kishin ofruar lokalin e tyre me qëllim të prostitucionit. Ndërsa B.B dhe L.B kishin ndihmuar me qëllim që të sigurojnë femra për ofrimin e shërbimeve seksuale për klient me para në kompensim prej 50-60 euro.

Tri të akuzuarat nuk e kishin pranuar fajësinë.

## 23. Dënime për pronarët e lokaleve që kishin mundësuar prostitucionin

### Gjykata Themelore në Gjiilan

Numri i lëndës: P.nr.616/2018

Dt. e ngritjes së aktakuzës: 25.07.2018

**Vepra penale:** “ofrimi i lokaleve për prostitucion”, nga neni 242 lidhur me nenin 31 të KPRK-së “mundësimi apo detyrimi në prostitucion”, nga neni 241 par.1 lidhur me nenin 31, të KPRK-së;

**Vendimi i gjykatës:** 5 muaj burgim dhe 300 euro; 5 muaj burgim dhe 500 euro; 120 ditë burgim me kusht brenda një viti dhe 1,000 euro

Në këtë rast që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit kishin kaluar **5 ditë**.

GjTh në Gjiilan, me 30 korrik 2018, të akuzuarin e parë për veprën penale “mundësimi apo detyrimi në prostitucion”, e kishte dënuar me 5 muaj burgim efektiv dhe 300 euro gjobë, edhe të akuzuarën e dytë për të njëjtën veprë penale e kishte dënuar me 5 muaj burgim efektiv, por me 500 euro gjobë, Ndërsa i akuzuari i tretë për veprën penale “ofrimi i lokaleve për prostitucion”, dënohet me 120 ditë burgim me kusht dënim i cili nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda një viti nuk kryen

ndonjë vepër tjetër penale, si dhe me 1,000 euro gjobë.

Sipas aktakuzës së ngritur me 25 korrik 2018, njëri i pandehur si pronar i biznesit ndërsa e pandehura si menaxhere e biznesit dhe masazhere, kishin mundësuar femrave të ndryshme që për qëllime të prostitucionit të ushtrojnë edhe shërbime seksuale, ndërsa i akuzuari i tretë sipas aktakuzës kishte ofruar me qera lokalim e tij për qëllime të prostitucionit.

Tre të akuzuarit kishin lidhur marrëveshje për pranimit të fajësisë.

#### **24. 90 ditë burgim për sulm seksual**

##### **Gjykata Themelore në Ferizaj**

**Numri i lëndës:** P.nr.176/16

**Dt. e ngritjes së aktakuzës:** 29.02.2016

**Vepra penale:** “*sulm seksual*”, nga neni 323 paragrafi 1 të KPRK-së;

**Vendimi i gjykatës:** 90 ditë burgim

Në këtë rast që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit kishin kaluar **1 vit e 4 muaj**.

GjTh në Ferizaj, DP, me 22 korrik 2019, të akuzuarin për veprën penale “*sulm seksual*”, nga neni 323 paragrafi 1 të KPRK-së, e kishte dënuar me 90 ditë burgim.

Sipas aktakuzës së ngritur me 29 shkurt 2016, i akuzuari H.Rr, derisa e dëmtuara V.D kishte qenë duke ecur me kunatën e saj, ndërsa para tyre kishin qenë burri i saj dhe kunati, i akuzuari iu ishte afuar dhe e kishte prekur viktimën në organ gjenital, ku e kishte vërejtur kunati i viktimës dhe të njëjtin e kishte dorëzuar në polici. I akuzuari nuk e kishte pranuar fajësinë.

#### **25. Dy mijë euro gjobë për sulm seksual**

##### **Gjykata Themelore në Ferizaj**

**Numri i lëndës:** P. nr.3175/17

**Dt. e ngritjes së aktakuzës:** 18.12.2017

**Vepra penale:** “*sulm seksual*”, nga neni 323 paragrafi 1 të KPRK-së;

**Vendimi i gjykatës:** 2,000 euro

Në këtë rast që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit kishin kaluar **1 ditë**.

GjTh në Ferizaj, DP, me 19 dhjetor 2017, të akuzuarin për veprën penale “*sulm seksual*”, nga neni 232 par.1, të KPRK-së, e kishte dënuar me 2,000 euro gjobë.

Sipas aktakuzës së përpiluar me 18 dhjetor 2017, i akuzuari T.M, derisa e dëmtuara kishte qenë duke punuar në zyrën e saj, kishte tentuar ta puthë duke e kapur me dy duart e tij.

Në këtë rast e dëmtuara kishte hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike. Rasti në fjalë kishte ndodhur me 17 dhjetor 2017, një ditë më pas me 18 dhjetor ishte ngritur aktakuzë, një ditë pas ngritjes së aktakuzës me 19 dhjetor 2017 gjykata kishte caktuar shqyrtimin fillestar, në të cilin i akuzuari pranuar fajësinë, në të cilën ditë edhe ishte shpallur aktgjykimi.

##### **Rekomandime:**

1.KGJK dhe KPK të marrin masa ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilët nuk respektojnë afatet ligjore në trajtimin e rasteve të veprave penale kundër integritetit seksual .

## 12. Annex 2: Analizë e aktgjykimeve me burgim me kusht për vepra penale kundër integritetit seksual

IKD përpos dënimeve me burgim efektiv, nga 56 rastet e analizuara ka vërejtur se gjykata themelore kanë shqiptuar edhe dënime me kusht, ku prej 76 personave të akuzuar për këto vepra penale, ndaj 17 prej tyre kanë shqiptuar dënime me kusht.

### 1. Dënim me kusht për keqpërdorim seksual të të miturës

**Gjykata Themelore në Gjakovë**  
**Numri i lëndës:** PKR.nr.356/2012  
**Dt. e ngritjes së aktakuzës:** 30.08.2012  
**Vepra penale:** “*keqpërdorimit seksual i personave nën moshën 16 vjeç*”, nga neni 198 paragrafi 1 të ish-KPK-së (Rregullorja e UNMIK 2003/25 e dt. 06.07.2002);  
**Vendimi i gjykatës:** 2 vite me kusht, brenda 4 vitesh

Në këtë rast që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit kishin kaluar mbi **7 vite**.

GjTh në Gjakovë, DM, me 4 tetor 2019, të akuzuarin B.T për shkak të veprës penale “*keqpërdorimit seksual i personave nën moshën 16 vjeç*”, nga neni 198 paragrafi 1 të ish-Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës ( Rregullorja e UNMIK 2003/25 e dt. 06.07.2002), e kishte dënuar me dy vite burgim me kusht, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda 4 vitesh nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Sipas aktakuzës së ngritur me 30 gusht 2012, i akuzuari B.T, e kishte keqpërdorur seksualisht të dëmtuarën 13 vjeçare, përkundër faktit që e kishte ditur se e

dëmtuara ishte nën moshën 16 vjet. I akuzuari e kishte pranuar fajësinë dhe kishte deklaruar se pas shtatë vitesh kishte ardhur nga Gjermania.

### 2. Dy vite burgim me kusht për marrëdhënie seksuale me dhunë

**Gjykata Themelore në Prishtinë**  
**Numri i lëndës:** PKR.nr.356/2012  
**Dt. e ngritjes së aktakuzës:** 13.07.2004  
**Vepra penale:** “*Marrëdhënie seksuale me dhunë*”, nga neni 74 alineja 2 pika 3 të LPK-së  
**Vendimi i gjykatës:** 2 vite me kusht, brenda 4 vitesh

Në këtë rast që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit kishin kaluar **14 vite e 10 muaj**.

GjTh në Prishtinë, me 3 qershor 2019, të akuzuarin për veprat penale “*Marrëdhënie seksuale me dhunë*”, nga neni 74 alineja 2 pika 3 të LPK-së, I.R e kishte dënuar me dy vite burgim me kusht, dënim i cili nuk do të ekzekutohet nëse i njëjti brenda periudhës prej 4 vitesh nuk kryen vepër tjetër penale.

Sipas aktakuzës së ngritur me 13 korrik 2004, i akuzuari së bashkë me të akuzuarin tjetër në nëntor të vitit 1999, kishin shkuar tek shtëpia e të ndjerës e kishin futur në makinë, e kishin dërguar në një fshat dhe pasi kishin kryer marrëdhënie seksuale me pretendimin se e njëjta kishte bashkëpunuar me policinë serbe, i akuzuari A.Xh kishte shtënë në drejtim të saj.

### 13. Annex 3: Analizë e aktgjytimeve me gjobë për vepra penale kundër integritetit seksual

IKD në 56 aktgjykimet e analizuara të veprave penale kundër integritetit seksual, ka vërejtur se nga 76 të akuzuar, gjykatat themelore ndaj 11 prej tyre kanë shqiptuar dënime me gjobë.

Dënimi më i lartë me gjobë i shqiptuar për këto vepra penale, është dënimi me **3,600 euro** gjobë për veprën penale “**Keqpërdorim seksual duke përdorur pozitën, autoritetin apo profesionin**”, dënimi me **2,000 euro** gjobë për “**sulm seksual**” dhe dënimi me **1,800 euro** për veprën penale “**keqpërdorim i fëmijëve në pornografi, lidhur me veprën penale pornografia me fëmijë**”.


Ndërsa për veprat penale “**sulm seksual**” dhe “**ngacmim seksual**”, vërehet se gjykata kanë kursyer të shqiptojnë dënime më të larta pasi për këto vepra penale kanë shqiptuar vetëm dënime me gjobë dhe në asnjërin rast nuk kanë shqiptuar dënime tjera.

Për veprën penale “**sulm seksual**”, për dy të akuzuar kanë shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 500 euro, në njërin rast për një të akuzuar kanë shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 400 euro, ndërsa në dy raste kanë shqiptuar dënim me 300 euro gjobë. Edhe për veprën penale “**ngacmimi seksual**”, gjykata kanë shqiptuar dënime me gjobë, ku në dy raste kanë shqiptuar nga 300 euro gjobë. Ndërsa dënimin më të ulët me gjobë e kanë shpallur për veprën penale “**Nxitja e akteve seksuale me premtim të rrejshëm të martesës**”, me 200 euro gjobë.

Pavarësisht, pse vepra penale “**Keqpërdorimi seksual duke përdorur**

pozitën, autoritetin apo profesionin”, sipas nenit 239 par.1 pika 1.1 të KPRK, dënohet me 1 deri me 5 vite burgim, gjykatat në këtë rast kanë shqiptuar dënim me gjobë, edhe pse në këtë nen nuk parashihet fare që kryesi të dënohet me gjobë.

Edhe për veprën penale “**keqpërdorim i fëmijëve në pornografi, lidhur me veprën penale pornografia me fëmijë**”, sipas nenin 238 paragrafit 1, kryesi dënohet me 1 deri në 5 vite burgim, gjykatat edhe në këtë rast kanë shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 1,800 euro, edhe pse në Kodin Penal nuk parashihet fare dënimi me gjobë.



Grafika 8: Llojet e dënimeve me gjobë sipas aktgjytimeve të analizuara.

### 14. Analizë e aktgjytimeve liruese për vepra penale kundër integritetit seksual

IKD ka analizuar edhe rastet e 15 personave që janë liruar për disa vepra penale kundër integritetit seksual.

IKD ka vërejtur se GjTh-të edhe pse dënimet më të lartë i kanë shqiptuar për veprën penale “**dhunimi**”, vërehet se për

këtë vepër penale ka pasur raste kur të akuzuarit në mungesë të provave përfundimisht i kishte liruar nga akuza.

Numrin më të madh të të akuzuarve që janë liruar nga akuza janë për këtë vepër penale, me gjithsej **7 të liruar**, për veprën penale “sulm seksual”, janë liruar dy (2) persona, ndërsa për vepra tjera penale si “keqpërdorimi seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin apo profesionin”, “keqpërdorim seksual i personave nën moshën 16 vjet”, “marrëdhënie seksuale me dhunë”, “mundësimi apo detyrimi në prostitucion” dhe “ofrimi i lokaleve për prostitucion”, janë liruar nga një (1) person, pra gjithsej 5 prej tyre për këto vepra penale.




**Grafika 10: Numri i të akuzuarve që janë liruar nga akuza krahasuar me veprat penale.**

### 15. Analizë e aktgjykimeve të integritetit seksual nga Gjykata e Apelit

Përpos aktgjykimeve të shkallës së parë, IKD ka analizuar edhe 25 aktgjykime të Gjykatës së Apelit, si shkallë e dytë dhe ka vërejtur se kjo gjykatë vetëm në 3 raste ka ndryshuar aktgjykimet e shkallës së parë, ndërsa 22 aktgjykime të tjera i ka vërtetuar.

IKD ka vërejtur se në këto 3 aktgjykime Gjykata e Apelit në të trija rastet **ka ulur** dënimet që i ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë dhe në asnjërin rast nuk i ka rritur dënimet e shqiptuara nga shkalla e parë.



**Grafika 11: Aktgjykimet e ndryshuara nga GjA për veprat penale kundër integritetit seksual**

Pra në të trija këto raste, Apeli nuk kishte gjetur shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, mirëpo kishte vlerësuar se gjykatat e shkallës së parë në këto raste nuk kishin vlerësuar mjaftueshëm rrethanat lehtësuese për tre të akuzuarit dhe se iu kishin shqiptuar dënime të ashpra.



Ndërsa sipas Apelit, zbutja e këtyre dënimeve ishte e mjaftueshme që të arrihet qëllimi i ndëshkimit. Ndërkaq në 22 aktgjykimet e tjera, Apeli kishte vërtetuar vendimin e shkallës së parë duke refuzuar si të pabazuara ankesat e palëve duke vlerësuar se gjykata e shkallës së parë kishte vepruar drejtë në 22 aktgjykimet e saja.

### **1. Dënohet me 7 vite për keqpërdorim të të miturës, Apeli ia ulë dënimin**

#### **Gjykata Themelore në Ferizaj**

**Vepra penale:** “keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjet”, nga neni 235 par.2 nënpar.2.3 lidhur me par.1 të KPRK;

**Vendimi i Themelores:** 7 vite

**Vendimi i Apelit:** 5 vite

GjTh në Ferizaj, me 18 prill 2017, të akuzuarin për veprën penale “keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjet, B.S e kishte dënuar me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) vite.

Mirëpo, Gjykata e Apelit me 15 tetor 2018, kishte vendosur që të akuzuarit t’ia ulë dënimin në dy vite me pak. Sipas Apelit, gjykata e shkallës së parë nuk i kishte vlerësuar rrethanat lehtësuese, se i akuzuari kishte pranuar fajësinë, se kishte pasur sjellje korrekte në gjykatë, se për herë të parë kishte rënë në kundërshtim me ligjin, se ishte mbajtës i vetëm i familjes.

Apeli në aktgjykimin e tij thuhet se kishte vlerësuar këto rrethana lehtësuese e sidomos kishte vlerësuar gjendjen ekonomike të akuzuarit si dhe faktin që i njëjti ishte familjar dhe mbajtës i familjes 7 anëtarësh të moshës jo madhore. Vendimi për ndryshimin e aktgjykimin të shkallës së

parë, kishte ardhur me bindjen se dënimi i shqiptuar ishte proporcional më përgjegjës penalo-juridike të akuzuarit dhe se me një dënim të shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

### **2. Apeli ia përgjysmon dënimin të akuzuarit për keqpërdorim seksual të të miturës**

#### **Gjykata Themelore në Prizren**

**Vepra penale:** “keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjet”, nga neni 235 par.2 nënpar.2.3 të KPRK;

**Vendimi i Themelores:** 5 vite

**Vendimi i Apelit:** 2.6 vite

**Vendimi i Apelit:** 5 vite

GjTh në Prizren me 7 gusht 2017, të akuzuarin për veprën penale “Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjet F.Gj e kishte dënuar me 5 vite burgim efektiv. Mirëpo, Gjykata e Apelit me 29 nëntor 2017, kishte ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë përkitazi me vendimin për dënimin dhe të akuzuarin F.Gj e kishte gjykuar me 2 vite e 6 muaj burgim.

Apeli kishte vlerësuar se dënimi në këtë çështje duhet të jetë më i ulët, pasi gjykata e shkallës së parë gjatë matjes së dënimin i kishte marrë për bazë rrethanat lehtësuese si: pranimin e fajësisë dhe faktin se kishte shprehur keqardhje, bashkëpunimi i

përgjithshëm i personit të dënuar me gjykatën dhe sjellja e tij pas ndodhjes së veprës, ndërsa si rrethana rënduese: se këto vepra paraqesin rrezikshmëri të lartë shoqërore, cenohet pjesa më e ndjeshme e shoqërisë, se pasojat e abuzimit seksual i ndjekin fëmijët edhe në fazat e mëvonshme të jetës, moshë e viktimës.

Mirëpo sipas Apelit, në rastin konkret rrethanat lehtësuese nuk ishin vlerësuar sa duhet dhe se kishte vend për një dënim më të butë, prandaj në mungesë të ndonjë rrethane veçanërisht rënduese Apeli kishte vendosur që ta përgjysmojë dënimin e shkallës së parë.

Sipas kësaj gjykate, duke pasur për bazë shkallën e përgjegjësisë penale, motivet për kryerjen e veprës, rrethanat në të cilat është kryer vepra, bashkëpunimin e të akuzuarit me gjykatën si dhe rrethanat personale të kryerësit dhe sjelljen e tij pas kryerjes së

Mirëpo, GjA me 13 nëntor 2019, ia kishte përgjysmuar dënimin në 1 vit e 6 muaj, duke e ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë. Sipas Apelit, kishte hapësirë ligjor që të akuzuarit ti zbutet dënimi në kuptim të nenit 75 par 2 të KPK lidhur me nenin 74 par 3, pika 3.3 të KPK, duke pasur parasysh rrethanat personale dhe karakterin e personit të dënuar, lidhur me pikën 3.6 dhe pikën 3.12 të të njëjtit nen të KPK, se kryerësi i veprës penale në kohën e kryerjes së të njëjtës, ka qenë i moshës së re, dhe sjellja e tij pas kryerjes së veprës penale ka qenë e mirë.

Sipas Apelit, kjo gjykatë kishte vendosur që të akuzuarit ti shqiptojë një dënim më të butë, duke qenë i bindur se dënimi i shqiptuar është në harmoni të plotë me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, intensitetin e rrezikshmërisë

veprës penale, faktin se më parë i akuzuari nuk ka qenë i dënuar, Apeli kishte aplikuar dispozitën e nenit 75 par.1 nën para 1.3 të Kodit penal, duke bërë zbutjen e dënimit, respektivisht ia ka shqiptuar të akuzuarit dënimin nën minimumin e paraparë me ligj ose dënimin më të butë.

### **3. I zbutet dënimi të akuzuarit për keqpërdorim seksual të të miturës**

#### **Gjykata Themelore në Mitrovicë**

**Vepra penale:** “keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjet”, nga neni 235 par.4 pika 4.1 lidhur me par.1 të KPRK;

**Vendimi i Themelores:** 3 vite

**Vendimi i Apelit:** 1.6 vite

GjTh në Mitrovicë, e 4 mars 2019, të akuzuarin për veprën penale “keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjeçare”, e kishte dënuar me 3 vite burgim.

shoqërore të veprës së kryer penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se ky dënim është në funksion të preventives gjenerale si dhe asaj individuale dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga kjo gjykatë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

## 16. Analizë e aktgjykimeve të integritetit seksual nga Gjykata Supreme

IKD ka analizuar edhe 5 raste të veprave penale të integritetit seksual për të cilat ka vendosur edhe Gjykata Supreme. Në tri

raste Supremja kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë i kishte cilësuar si të pabazuara, njërin rast e kishte kthyer në rivendosje dhe në njërin rast i kishte ndryshuar të dyja aktgjykimet atë të themelores dhe Apelit.

Vepra penale	Numri i të akuzuarve	Vendimi i shkallës së parë	Vendimi i shkallës së dytë	Vendimi i Supremes
Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjet	1	3 vite	Vërtetim	Refuzim
Shërbime seksuale të viktimës së trafikimit, Keqpërdorimi seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin apo profesionin	4	4 vite dhe 1,500 euro, 1 vit e dy muaj, 3,600 euro gjobë, 2,000 euro gjobë	Vërtetim	Refuzim
Ofrimi i materialit pornografik personave nën moshën 16 vjeçare	1	6 muaj	Vërtetim	Rivendosje
Sulm seksual	1	3 vite	Vërtetim	Refuzim
Shërbime seksuale të viktimës së trafikimit, trafikimi me njerëz, armëmbajtje pa leje	4	4 vite e 6 muaj dhe 2,000 euro gjobë, 2 vite e 1 muaj dhe 1,000 euro gjobë, 2 vite e 10 muaj dhe 1,000 euro gjobë, 3,500 euro	Vërtetim	Ndryshim

Tabela 13: Vendimet e Gjykatës Supreme për të akuzuarit për vepra penale të integritetit seksual

### 1. Supremja e kthen në rigjykim rastin ndaj të akuzuarit për ofrim

### të materialit pornografik të miturit

**Gjykata Themelore në Prishtinë**  
**Vepra penale:** “ofrimi i materialit pornografik personave nën moshën 16 vjeçare”, nga neni 237.par.1.të KPK  
**Vendimi i Themelores:** 6 muaj  
**Vendimi i Apelit:** Vërtetim  
**Vendimi i Supremes:** Rigjykim

GjTh në Prishtinë, me 5 nëntor 2018, të akuzuarin I.A. për veprën penale “ofrimi i materialit pornografik personave nën moshën 16 vjeçare”, e kishte dënuar me 6 muaj burgim, të cilin dënim edhe Gjykata e Apelit ia kishte vërtetuar me 8 maj 2019.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë të përbashkët për mbrojtjen e ligjshmërisë

kishin paraqitur në Gjykatën Supreme dy mbrojtësit e të dënuarit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënimin, me propozim që të ndryshohen dhe i dënuari të lirohet nga akuza ose që lënda të kthehet në rivendosje.

Supremja me 8 maj 2019 i kishte anuluar dy aktgjykimet e shkallës së parë dhe të dytë, dhe lëndën ia kishte kthyer shkallës së parë në rivendosje. Sipas Supremes, nga ekspertiza ishte vërtetuar se shumë foto të nxjerra nga telefoni i të dënuarit nuk i përkasin kësaj çështje dhe po ashtu sipas kësaj gjykate këto shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nuk i kishte eliminuar as Apeli. Kjo gjykatë në rigjykim kishte kërkuar nga shkalla e parë që të administrojë serish provat dhe të vlerësohet edhe një herë konstatimi i ekspertit për fotografitë e gjetura në telefonin e të dëmtuarës në mënyrë që të vërtetohet se për cilat fotografi bëhet fjalë dhe se a ishin dërguar nga telefoni i të dënuarit.

## **2. Supremja ia ndryshon dënimet të akuzuarve për trafikim dhe shërbime seksuale**

### **Gjykata Themelore në Prishtinë**

**Vepra penale:** “trafikimi me njerëz”, “shërbime seksuale të viktimës së trafikimit”, etj

**Vendimi i Themelores:** 2 vite, 10 muaj, 2.000 euro gjobë; i akuzuari i dytë me 3,500 euro

**Vendimi i Apelit:** Vërtetim

GjTh në Prishtinë, me 23 dhjetor 2016, të akuzuarin B.K për “trafikimi me njerëz”, e kishte dënuar me 4 vite dhe 2,000 euro gjobë, ndërsa për armëmbajtje pa leje e kishte dënuar me 8 muaj, ndërsa ndaj tij

ishte shqiptuar dënim unik prej 4 vite e gjashtë muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 2,000 euro. I akuzuari Gj.B për “trafikim me njerëz në ndihmë”, ishte dënuar me 2 vite dhe 1.000 €, ndërsa për “shërbime seksuale të viktimës së trafikimit”, 2 vite, ndërsa ndaj tij gjykata kishte shqiptuar dënim unik në kohëzgjatje prej 2 vite e 10 muaj dhe 1,000 euro. I akuzuari I.Z për “trafikim me njerëz”, është dënuar me 2 vite e 1 muaj dhe 1.000 euro gjobë, ndërsa i akuzuari për “shërbime seksuale të viktimës së trafikimit”, F.B është dënuar me gjobë në shumë prej 3,500 euro.

Këtë aktgjykim e kishte vërtetuar edhe GjA me 27 korrik 2017. Mirëpo, GjS me 30 prill 2018 kishte ndryshuar dy aktgjykimet përkritazi me cilësimin juridik të veprës penale dhe vendimin mbi dënimin. Kjo gjykatë, të akuzuarin Gj,B e kishte gjykuar me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, ndërsa dënimin me gjobë në shumë prej 1.000 € e kishte vërtetuar, pasi kishte cilësuar veprën penale në trafikim me njerëz në ndihmë.

Ndërsa kërkesa e të akuzuarit Gj.B dhe B.K refuzohen si të pabazuara. Sipas Supremes, është shkelur dispozita e nenit 270, të cilën dispozitë e citon duke mos specifikuar se në çfarë kuptimi është shkelur kjo dispozitë por thekson se gjykata e shkallës së dytë i ka injoruar shkeljet esenciale pa dhënë ndonjë arsyetim për këtë pretendim. Lidhur me shkelje të ligjit penal në kërkesë potencohet se për shkak të shkeljeve esenciale është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit ndërsa, asnjë gjykatë nuk ka dhënë arsye për figurën e veprës penale të trafikimit e as për ndihmë.

Sipas Supremes, qëndron fakti se në dispozitivin I. të aktgjykimit është dhënë një përshkrim faktik të veprës penale trafikimi me njerëz nga neni 171 por të gjithë të dënuarit, mirëpo, në këtë përshkrim janë specifikuar të gjitha veprimet konkrete të secilit prej të dënuarve si dhe rrethanat për ndihmën për të dënuarit Gj. dhe I. i cili përshkrim është kompatibil dhe me cilësimin juridik të veprës penale për çfarë pretendimi rezulton të jetë i pabazuar. Sipas Supremes, dy gjykatat gabimisht kishin aplikuar ligjin penal në raport me të dënuarin Gj.B., kur e ka shpallur fajtor edhe për veprën penale shërbime seksuale të viktimës së trafikimit nga neni 231 par.2 lidhur me par.1 të KPK, kjo vepër konsumohet në veprën penale të trafikimit me njerëz sepse me pa mëdyshje është vërtetuar se i dënuari Gj. ka kryer këtë vepër penale.